



*Shërbullor
konces*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI HETIMOR "PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË
SISTEMIT TIMS"

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2024

Lënda: Përcjellje e Raportit Përfundimtar të komisionit hetimor "Për trajtimin e të dhënave të sistemit TIMS"

Drejtuar: Znj.Lindita Nikolla
Kryetare e Kuvendit

Zonja Kryetare,

Bashkëlidhur gjeni Raportin Përfundimtar të komisionit hetimor "Për trajtimin e të dhënave të sistemit TIMS", ku përfshihet mendimi i shumicës parlamentare dhe i pakicës parlamentare.

Duke Ju falënderuar paraprakisht,

KRYETAR

ERVIN SALIANJI



**KUVENDI
KOMISIONI HETIMOR**

V E N D I M
(përfundimtar)

Nr.26 , datë 23.07.2024

“PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS”

Në mbështetje të neneve 20 dhe 22 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funkionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, i ndryshuar, dhe pikës IV, të vendimit nr. 20/2024 të Kuvendit të Shqipërisë, me propozim të kryetarit të Komisionit,

KOMISIONI HETIMOR

V E N D O S I:

- I. Miratimin e Raportit Përfundimtar, bashkëlidhur këtij vendimi.
- II. Raporti Përfundimtar i dërgohet Kuvendit për miratim në seancë plenare.
- III. Komisioni i kërkon Kuvendit që Raporti Përfundimtar t'i përcillet Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për fillimin e çështjes penale.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Ervin SALIANJI

RAPORTI PËRFUNDIMTAR

I KOMISIONIT HETIMOR

“PËR TRAJTIMIN E TË DHËNAVE TË SISTEMIT TIMS”

PËRMBAJTJA

1. HYRJE
2. Baza Ligjore
- 2.1 Objekti i Hetimit
3. Te dhëna mbi çështjen objekt hetimi, plani i hetimit
- 3.1 Fusha dhe qëllimi
4. Burimet e informacionit hetimor
5. Afati kohor
6. Identifikimi i kufijve kohore të hetimit
7. Personat e thirrur për dëshmi
8. Fakte, Rrethana, Gjetje
- 8.1 Hetimi dhe Verifikimi i të Dhënave
9. Dokumente Zyrtare
10. Dëshmitë
11. Kryqezimi i të dhënave
12. Fakte dhe Detaje të Rezultuara nga aktet e administruara në këtë hetim
- 12.1 Teknika e Vlerësimit të hetimit
13. Konkluzione
- Menaxhimi i sistemit TIMS dhe kontrolli i kufijve
14. Konkluzione Dhe Rekomandime
15. Shtojcat

I. HYRJE

1. *Vendimi i Kuvendit të Shqipërisë për ngritjen Komisionit Hetimor Parlamentar*

1.1 Kuvendi i Shqipërisë, me vendimin nr. 20, datë 21.03.2024, ka vendosur ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit “Për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS”. Objekt i veprimtarisë të këtij komisioni është:

- i. Shqyrtimi i çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS.
- ii. Vlerësimi i nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës.

1.2 Komisioni Hetimor, e zhvilloi veprimtarinë e tij bazuar në nenin 77 të Kushtetutës, në ligjin nr.9889, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit” (i ndryshuar), si dhe në Planin Hetimor të miratuar prej tij.

1.3 Komisioni hetimor parlamentar për sistemin TIMS, në datën 2-4-2024, deklaroi konstituimin e tij, dhe zgjodhi sekretarin e komisionit. Bashkëlidhur këtij raporti, gjendet Shtojca, në të cilën identifikohet, lista e anëtarëve të komisionit hetimor, në të cilën janë përfshirë edhe anëtarët zëvendësues, pjesë e pandarë edhe integrale e këtij raporti.

1.4 Komisioni Hetimor, zhvilloi 17 mbledhje, detajet e të cilave, prezantohen në seksionin “*afati*”, të këtij raporti, më poshtë.

1.5 Komisioni Hetimor Parlamentar, me objekt, si më lart, i zhvilloi “*hetimet*”, duke respektuar kufijtë e ligjit, pa marrë të pandehur, pa ngritur akuzë penale, e pa përthithur asnjë juridiksion apo kompetencë, që sipas kushtetutës dhe ligjeve specifike në fuqi, i takojnë organeve të pavarura dhe të posaçme, që ngrenë akuzën në emër të shtetit edhe që japin drejtësi në emër të shtetit.

1.6 Procesi hetimor i komisionit, u lehtësua dhe u ndihmua nga ekspertët ligjorë, të cilët, për shkak të njohurive profesionale, u thirrën nga ky komision, për të sugjeruar marrjen e informacioneve, akteve, mbi ngjarje apo dokumente, që lidheshin me hetimin, për sistemin TIMS. Me vendimin e komisionit hetimor, të datës 8-04-2024, akt i miratuar me 2/3 e anëtarëve, u aprovua thirrje e ekspertëve ligjorë, të propozuar dy nga shumica parlamentare dhe dy nga pakica parlamentare. Bashkëlidhur këtij raporti, gjendet Shtojca, në të cilën identifikohet, lista e ekspertëve ligjorë, pjesë e pandarë edhe integrale e këtij raporti.

1.7 Pas njohjes, së ekspertëve ligjorë me objektin e komisionit hetimor, si dhe objektin e çështjes që do të hetohej, komisioni, u këshillua nëpërmjet ekspertëve ligjorë, me shkrim mbi institucionet, që duhet t’ju drejtohej, për të mbledhur të dhëna dokumentare për çështjen objekt hetimi.

1.8 Të dhënat e kërkuara nga komisioni hetimor dhe të sugjeruara nga ekspertët ligjorë, për institucionet ligj-zbatuese, kishin lidhje të drejtpërdrejtë me kontrollin administrativ të veprimtarisë së institucioneve, si Ministria e Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit,

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave, si dhe organe të tjera, të cilat, në mënyrë shteruese prezantohen në seksionin “*autoritetet ligj zbatuese*” më poshtë. Në tërësi, i gjithë kërkimi i përcjellë për informacion ishte për informacion zyrtar.

1.9 Ekspertët ligjorë, me vendosjen në dijeni të informacioneve shkresore të mbërritura, pranë komisionit hetimor për sistemin TIMS, i raportuan gjetjet e tyre verbalish, si dhe në datën 08-05-2024, propozuan me shkrim planin e hetimeve.

1.10 Mbështetur në sugjerimet e propozimet e ekspertëve, komisioni hetimor, për sistemin TIMS, miratoi, pas debatesh në datën 08-05-2024, me vendim të ndërmjetëm *planin e hetimeve*, si bashkëlidhur pjesë e pandarë e këtij raporti.

1.11 Plani i hetimeve, i miratuar me vendimin e ndërmjetëm të datës 08-05-2024, përfshiu të gjithë hapat proceduralë, veprimet hetimore, që u ndoqën nga komisioni për hetimin e çështjes, si dhe rrethin e personave që u thirrën, si dëshmitarë, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale.

1.12 Pas miratimit të planit të hetimit, me vendimin e ndërmjetëm të datës 08-05-2024, nga kryetari i komisionit, u deklarua “fillimi i hetimeve”.

1.13 Me miratimin e planit të hetimeve, komisioni hetimor, zhvilloi veprimtari dhe administroi, si “*provë*” çdo të dhënë, dëshmi, dokument dhe fakt, që shërbeu në nxjerrjen e konkluzioneve të hetimit, të cilat u morën sipas ligjit. Bashkëlidhur këtij raporti, gjendet lista e akteve dokumentare të administruara, pjesë e pandarë e tij.

1.14 Me miratimin e planit të hetimeve, komisioni hetimor aprovoi, listën e të thirrurve si “*dëshmitar*” për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet që ata dinin, në lidhje me çështjen objekt hetimi. Bashkëlidhur këtij raporti, gjendet lista e dëshmitarëve të thirrur, pjesë e pandarë e tij.

1.15 Plani i Hetimeve i miratuar me vendimin e ndërmjetëm të datës 08-05-2024 të komisionit hetimor, për sistemin TIMS, nuk ndryshoi gjatë zhvillimit të hetimeve, pasi nën vlerësim të të dhënave të përfuara nga autoritetet, kompetente e ligj zbatuese, nuk dolën prova e ngjarje të reja, që lidheshin me çështjen.

1.16 Në të gjitha veprimet procedurale hetimore komisioni, veproi me “*vendime te ndërmjetme*”, në çdo fazë të hetimit për ndërmarrjen e procedurave të mëtejshme të hetimit, të pyetjes së dëshmitarëve, thirrjes së ekspertëve, kërkimit të informacionit dhe të dokumenteve zyrtare. Bashkëlidhur këtij raporti, gjendet lista e vendimeve të marra nga komisioni, pjesë e pandarë e tij.

1.17 Me anë të këtij raporti, ju përcillen për vlerësim gjetjet, rekomandimet e konkluzionet, që orientojnë një konkluzion përfundimtar. Me “*Vendimin përfundimtar*” që merret nga komisioni, miratohet, teksti i raportit, i cili përmban pjesën konstatuese dhe konkluzionet e hetimit.

II. BAZA LIGJORE

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. **8891, datë 2.05.2022** Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore” i ndryshuar
- Kodi i Procedurës Penale
- Rregullorja e Kuvendit të Shqipërisë.

2.1 Objekti i Hetimit

2.1. Në mbështetje të nenit 77 pika 2, te Kushtetutës, si dhe të paragrafit 4, të nenit 11 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 (i ndryshuar), si dhe mbështetur ne vendimin nr.20 date 21-03-2024 të Kuvendit të Shqipërisë, komisioni hetimor parlamentar “Per trajtimin e të dhënave të sistemit TIMS”, zhvilloi hetimin.

2.2 Komisioni hetimor parlamentar “Per trajtimin e te dhënave te sistemit TIMS”, veproi në çdo fazë të hetimit në zbatim të **“Planit hetimor për sistemin TIMS”**, si dhe ligjit.

2.3 Në ushtrimin e funksioneve të tij, përveç detyrave të parashikuara në ligj, komisioni i hetimit parlamentar **për kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS**, ushtroi këto drejta dhe kreu këto detyra:

a- hetoi, sipas përcaktimeve të bëra në ligj dhe brenda kufijve të objektit të Vendimit nr.20 date 21-3-2024 të Kuvendit të Republikës se Shqipërisë.

b- kërkoi nga institucionet ligj-zbatuese informacione dhe dokumente zyrtare

c- Thirri titullarë institucionesh për pyetje

d- Mori në pyetje dëshmitarë dhe persona të tjerë

e- Mori vendime, sipas rregullave të parashikuara në ligj.

f- Përgatiti raportin për dhe miratim me vendimin përfundimtar të hetimit, së bashku me mendimin e pakicës (nëse do të ketë).

2.4 Kufijtë e jashtëm te shtetit Shqiptar, i nënshtrohen zbatimit të rregullave të shkruara nga strukturat përgjegjëse, sipas ligjit 71/2016 (i ndryshuar), që bashkërendon aktivitetet e kontrollit kufitar, pa përjashtuar edhe mbikëqyrjen e kontrollin parlamentar.

2.5 Komisioni hetimor, kreu veprimtarinë e kontrollit ligjor, nëpërmjet verifikimit të zbatimit të akteve ligjore dhe nënligjore, nga **autoritetet ligj zbatuese**, referuar ligjit 71/2016, si dhe në mënyrë strikte nga respektivisht:

a-Autoritetet kompetente, të cilat kanë të drejtë të kërkojnë, të konsultojnë, të marrin të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave penale, sipas nenit 19/3, të ligjit 71/2016 (i ndryshuar), janë:

i. strukturat operationale të Policisë së Shtetit;

- ii. *Shërbimi Informativ i Shtetit;*
- iii. *Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;*
- iv. *Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;*
- v. *Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.*

2.6 Organet ligj zbatuese u identifikuan, sipas ligjit në fuqi edhe titullarët e tyre u thirren nga Komisioni Hetimor, për të dëshmuar, duke ndjekur rregullin e renditjes në dëshmi sipas ligjit, përkatësisht:

- a. *Ministria e Punëve të Brendshme (neni 5, 19/5 ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
 - i. *Drejtoria e Policisë Kufitare dhe Migracionit (neni 5/2 ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
 - ii. *Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (neni 19/5 ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
 - iii. *Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit neni (19/5 ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
- b. *Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (neni 19/7, ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
- c. *Shërbimi Informativ i Shtetit; (neni 19/5, ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
- d. *Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes; (neni 19/5, ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
- e. *Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; (neni 19/5, ligji 71/2016 (i ndryshuar))*
- f. *Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. (neni 19/5, ligji 71/2016 (i ndryshuar))*

2.7 Hetimi i Komisionit Parlamentar për mbarëvajtjen e funksionimit të sistemit TIMS, përgjatë veprimtarisë së tij veprimi, vetëm brenda ***hapësirës kontrolluese të parlamentit***, të lidhur ngushtësisht dhe në mënyrë funksionale me pushtetin legjislativ. Komisioni hetimor parlamentar, megjithëse, mori nën pyetje si dëshmitar, persona, që janë nën hetim nga organi i prokurorisë, respektoi kufizimet ligjore denjësisht, me detyrë të mbyllura edhe pa prezencë për publikun, edhe duke qenë tërësisht i qartë me kufijtë e këtij hetimi, që i jep Kushtetuta edhe ligji, gjatë veprimeve të kryera brenda fushës së veprimtarisë së tij.

2.8 Nëpërmjet hetimit, komisioni parlamentar, për sistemin TIMS, kreu një kontroll efektiv mbi zbatimin e ligjeve në fuqi nga organet dhe funksionarët publikë, me synim, nxjerrjen e përgjegjësve institucionale dhe vlerësimin e nevojës për miratim, shfuqizim, apo ndryshim të dispozitave të kuadrit ligjor në fuqi. Qëllimi hetimit synoi, që nëpërmjet hetimit të identifikoheshin

problemet dhe me rekomandimet për përmirësim të vendosen standardet më të larta të sigurisë dhe të mbrojtjes në bazat e të dhënave të sistemit TIMS.

2.9 Kontrolli i plote mbi procedurat edhe proceset e zbatuara nga policia kufitare, si dhe autoritetet e tjera të përfshira nga ligji 71/2016, duke përfshirë e mos anashkaluar edhe rregullat mbi kompetencat e policisë kufitare dhe mjetet juridike në dispozicion të individëve, si dhe rastet kur tejkalohen këto kompetenca, përbëri, boshtin e këtij hetimi.

3. Te dhëna mbi çështjen objekt hetimi, plani i hetimit

3.1 Në mbështetje të paragrafit 4, të nenit 11 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 (i ndryshuar), ngritja e këtij komisioni hetimor të Kuvendit u bë me kërkesë të deputetëve të opozitës dhe në kërkesë specifikohej, se qëllimi i komisionit është:

- i. Shqyrtimi i çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS;***
- ii. Vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës në fuqi.”***

3.1.3. Ky komision ka ndërmarrë këtë hetim të ndërlidhur me ngjarjen e ndodhur në datë 02-08-2023 ora 22.54 në tentativën për të eksportuar të dhëna të sistemit TIMS, edhe e ka shtrirë veprimtarinë e hetimit për këtë ngjarje përgjatë vitit 1-1-2023 deri në 31-12-2023, ndaj veprimtarisë së institucioneve shtetërore kompetente e përgjegjëse për veprimtarinë kufitare, dhe menaxhimin e sistemit informatik TIMS, si sistem i përdorur në kontrollet në kufi nga policia në kufijtë e jashtëm të Shqipërisë.

4. Fusha dhe qëllimi

4.1 Për sa kohë, që rregullat për transmetimin e të dhënave të pasagjerit dhe regjimin e kontrollit kufitar të personave, që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë, mbrohen me ligj të veçantë, interesi për të hetuar, nëse sistemi i transmetimit dhe zbatimit të regjimit të kontrollit kufitar, ka dështuar në ndonjë moment apo është cenuar në ndonjë formë, përbëri interes të veçantë në hetim, jo vetëm për interesin publik, por edhe për mbarëvajtjen e veprimtarisë së organeve shtetërore të ngarkuara me ligj në këtë disiplinë.

4.2 Nëpërmjet, komisionit hetimor, “çështje e veçantë” që u hetua ishte për kontrollin e veprimtarisë dhe mbrojtjes së sistemit TIMS. Kjo çështje u hetua në aspektin e kontrollit dhe zbatimit të ligjeve, të njohjes dhe verifikimit në thellësi të kësaj veprimtarie edhe të strukturave, që janë ngarkuar për mbarëvajtjen e kësaj discipline, e cila është e mbrojtur me ligj.

5. Burimet e informacionit hetimor

5.1 Veprimtaria e komisionit hetimor parlamentar, përgjatë 4 muajve u zhvillua edhe përfshiu veprimtarinë hetimore me:

a- listën e personave për të dëshmuar, identifikuar në shtojcën bashkëlidhur

b- aktet rregullative e normative për transmetimin e të dhënave të pasagjerit dhe regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë;

c- aktet rregullative e normative që sigurojnë mirëmbajtjen, kontrollin dhe vijueshmërinë e punës së pajisjeve teknike (për regjistrimin e transmetimin e të dhënave në kontrollin kufitar).

d- mendimin e eksperteve

5.2 Në mbështetje të neneve 14/b, 15/1 dhe 17 të ligjit nr.8891, datë 02.05.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, Vendimit të Kuvendit të Shqipërisë “Për Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS”, u kërkuar pranë institucioneve shtetërore të përmendur në shtojcën bashkëlidhur këtij raporti, vendosja në dispozicion e informacioneve dhe dokumenteve, që dispononin për objektin e hetimit.

5.3 Çdo kërkesë e adresuar ndaj institucioneve shtetërore për informacion, u debatua në komision edhe në fund përmbajtje dhe objekti i çdo shkresë u miratua me vendim të ndërmjetëm të komisionit rregullisht. Objekt i kërkimit për komisionin qene aktet që listohen më poshtë:

1. Dokumente (akte rregullatorë, normative që normojnë administrimin, hedhjen e të dhënave, përditësimin dhe procedimin e informacionit të sistemit TIMS, lidhur me mënyrën e trajtimit, administrimit, mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave të sistemit TIMS), adresuar:

i. Ministrisë së Punëve të Brendshme

ii. Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore

iii. Drejtorisë së Përgjithshme e Policisë së Shtetit

iv. Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

v. Autoritetit Kombëtar të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar

vi. Drejtues i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të

Përgjithshëm Tiranë

vii. Drejtues i Strukturës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

iv. Shërbimit Informativ Shtetëror,

2. Rregulloret e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së sistemeve të automatizuara të verifikimit kufitar, ku, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve elektronike, mblidhen të dhëna për identifikim dhe për qëllim të verifikimit kufitar të automatizuar.
3. Aktet me të cilat ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike mund të ketë deleguar kompetencën, për kontrollin kufitar ose për bashkëpunimin ndërkufitar, plotësisht ose pjesërisht, një strukture të varësisë, nëse nuk është e ndaluar në bazë të marrëdhënieve të bazuara në të drejtën ndërkombëtare të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

4. Aktet normative qe normojnë rregullat për organizimin, funksionimin e NIP-it, si dhe për përdorimin e aksesin në bazën e të dhënave të pasagjerit, rregullat për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.
5. Udhëzimin e përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, që siguron nivelin e përshtatshëm të mbrojtjes të të dhënave, përfshirë dhe rastet e problemeve teknike, dhe të dhënat që transmetohen.
6. Rregulloren për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit te miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave
7. Aktet te cilat rregullojnë veprimtarinë e “Njësisë se informacionit të pasagjerit”, si strukture pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, e cila përpunon të dhënat e pasagjerit.
8. Strategjia e shkruar operationale e teknike për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.
9. Sistemet e informacionit për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.
10. Mekanizmat e kontrollit të cilësisë për të siguruar zbatimin e kërkesave te ligjit për përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit, përfshirë dhe mekanizmat e kontrollit të cilësisë për Sistemet e informacionit.
11. Aktet me te cilat është vlerësuar prodhimi dhe përdorimi i profileve të riskut dhe të modeleve të kontrollit, të krijuara nga NIP-i.
12. Auditimet e kryera për zbatimin e kontrollin e rregullave për organizimin, funksionimin e NIP-it, si dhe për përdorimin e aksesin në bazën e të dhënave të pasagjerit përpunimin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.
13. Masa administrative qe mund te jene marre ndaj personave qe u është deleguar përpunimi i te dhënave te pasagjerit.
14. Kodin e etikës së trupës së policisë së kufirit që zbaton rregullat e përpunimit të të dhënave të pasagjerit, praktikën anti-korrupsion, strategjinë e zbatimit, dhe planet për zbatimin e saj në trupën e policisë së kufirit.
15. *Disaster Recovery Plan*, për sistemin e të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.
16. Çdo informacion tjetër të nevojshëm për përmbushjen e detyrave nga ana e Komisionit, sipas objektit të punës së Komisionit.

6. Afati kohor

6.1 Komisioni hetimor parlamentar për sistemet TIMS e ushtroi veprimtarinë e tij për një periudhë 4-mujore, sipas vendimit të Kuvendit, në një kalendar takimesh të mbajtura, sipas kërkesave të ligjit për komisionet hetimore në përkatësisht datat:

02-04-2024, 08-04-2024, 12-04-2024, 15-04-2024, 19-04-2024, 29-04-2024, 08-05-2024, 13-05-2024, 15-05-2024, 04-06-2024, 11-06-2024, 26-06-2024, 02-07-2024, 10-07-2024, 15-07-2024, 19-07-2024.

6.2 Ne datën 15-07-2024 u zhvillua mbledhje për marrjen e dëshmisë së dëshmitarit të fundit të thirrur, sipas planit të miratuar të hetimit me vendim të ndërmjetëm të komisionit.

6.3 Ne datën 19-07-2024, u vendos përfundimi i hetimit, duke i hapur rrugën kështu, ndërtimit e vlerësimit të raportit përfundimtar. Në këto kushte rezultoi se komisioni hetimor e plotësoi, afatën shterues ligjor për mbylljen e punëve të komisionit hetimor TIMS maksimumi deri më **21 Korrik të vitit 2024**.

6.4 Identifikimi i kufijve kohore të hetimit

6.4.1 Në këto rrethana, ky komision hetimor parlamentar, hetoi sipas objektit të themelimit të tij për një çështje konkrete, që ka të bëjë me funksionin ligjvënës të Kuvendit. Objekti i hetimit është i qartë edhe fokusohet në çështje dhe në subjekte konkrete, për të cilat ekzistojnë të dhëna ose indicie të mjaftueshme për ekzistencën e problematikave, ekzistenca e të cilave është bërë publike, mbi çështjet për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit TIMS.

6.4.2 Mbi këto problematika u kërkua edhe aprovua edhe ngritja e komisionit hetimor, e në këtë kuptim kufijtë kohorë të shtrirjes së hetimit, u lidhen me kohën, kur publikisht u njoftua, se një ngjarje në mbarëvajtjen e sistemit TIMS, ndodhi.

6.4.3 Ky komision, bazuar në vendimin e Kuvendit e shtriu veprimtarinë e tij hetimore në periudhën kohore 1-1-2023 deri në 31-12-2023 “Për mbarëvajtjen e funksionimit të sistemit TIMS në RSH”.

7. Personat e thirrur për dëshmi

7.1 “**Dëshmitar**” është personi i thirrur nga komisioni për të dëshmuar mbi ngjarjet dhe faktet që ai apo ajo di, në lidhje me çështjen objekt hetimi. Në listën e dëshmitarëve prezantuar në Shtojcën bashkëlidhur këtij raport, janë identifikuar emrat e personave, të cilët, ushtrojnë veprimtari administrative, brenda qëllimit dhe fushës së veprimit të ligjit (71/2016 (i ndryshuar)), që rregullon edhe normën veprimtarinë e mbarëvajtjen e funksionimit të sistemit TIMS.

7.2 Përfshirja e emrave të renditur në Shtojcën bashkëlidhur këtij raport, si një listë shteruese paraprake u miratua me planin e hetimit, edhe ishte një mënyrë e përshtatshme, për të filluar e zhvilluar procesin hetimor, sipas parimeve të nenit 77 (2) të Kushtetutës edhe ligjit nr.8891 date 2-5-2002 (i ndryshuar).

7.3 Komisioni hetimor i posaçëm i miratuar nga Kuvendi me vendimin nr.20 date 21-03-2024, mori dëshmi të vlefshme me shkrim dhe me gojë nga një gamë e gjerë dëshmitarësh, e në përmbajtje të këtij raporti e vlerësojmë bashkëpunimin e tyre për të realizuar hetimin me pergjegjesi.

7.4 Komisioni hetimor parlamentar per sistemin TIMS, veprimi, sipas rregullave procedurale te rregullores se Kuvendit.

7.5 Çdo anëtar i komisionit hetimor, i krijuar, sipas Vendimit nr.20, date 21-03-2024 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, u vu ne dijeni te faktit, qe mbledhjet e komisionit, si rregull janë të hapura.

7.6 Komisioni hetimor, miratoi përjashtimin e publikut nga mbledhjet e tij, kur kjo u kërkua nga dëshmitarët e thirrur nen dëshmi dhe pasi referuar informacionit paraprak te administruar, plotësoheshin njëherazi kushtet:

a) *Dëshmitë, do t'u referohen, fakteve që kanë të bëjnë me informacion sekret, sekret hetimor.....;*

7.7 Komisioni parlamentar ne përmbushje te objektivave te hetimit, ne respekt te legjislacionit ne fuqi, vendosi, qe seancat e dëshmimeve te dëshmitarëve, per tu thirrur sipas planit te hetimit, te zhvilloheshin me dyer te mbyllura, pa publik, ne te gjitha rastet, kur kjo u kërkua nga dëshmuesi, si dhe u plotësuan kushtëzimet e ligjit ne fuqi.

7.8 Kryetari i komisionit, mbështetur, jo vetëm ne dispozitat e ligjit ne fuqi, por edhe te planit te hetimit te miratuar, i informoi, personat, që morën pjesë në mbledhjet e zhvilluara me dyer të mbyllura te komisionit për detyrimin, që ata kanë, për të ruajtur konfidencial, informacionin e mësuar në mbledhje.

III. Hetimi dhe Verifikimi i te Dhënave

8. Fakte, Rrethana, Gjetje

8.1 Dokumente Zyrtare - Komisioni hetimor per veprimtarinë e sistemit TIMS kërkoi nga institucionet ligj-zbatuese informacione dhe dokumente zyrtare. Aktet shkresore te administruara, nëpërmjet shkresave te përcjella nga institucionet ligj zbatuese pranë këtij komisioni, janë analizuar edhe vlerësuar per teresine e informacionit te perftuar prej tyre. Informacioni i perftuar eshte kryqezuar me cdo prove dhe te dhene tjeter te perftuar gjate veprimtarise hetimore te komisionit.

9. Dëshmitare - Komisioni hetimor parlamentar per veprimtarinë e sistemit TIMS, thirri titullarë institucionesh për pyetje. Dëshmitë e administruara në seancat e zhvilluara te komisionit, ne zbatim te planit te hetimit te përcjella nga institucionet ligj zbatuese pranë këtij komisioni janë vlerësuar me teresine e te gjitha provave te tjera te administruara prane komisionit.

10. Kryqezimi i te Dhenave

10.1 Komisioni hetimor, sipas objektit verifikoi:

10.1.1. Detyrat e kryera **nga ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë**, sipas parashikimeve të nenit 23 dhe 24 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar).

Rezultoi në hetimin e kryer, se janë miratuar dy VKM dhe tre Udhëzime, sipas parashikimeve të nenit 23 (paragraf 2) 24. Me Komisionerin e Mbrojtjes së të Dhënave është miratuar Udhëzimi i Përbashkët. Aktet janë miratuar brenda 6-mujorit nga miratimi i Ligjit 71/2016 (i ndryshuar), nga Kuvendi. **Ne fletoren zyrtare gjenden lehtësisht aktet nënligjore në zbatim të Ligjit 71/2016 (i ndryshuar).**

10.1.2. Detyrat e kryera **nga Policia Kufitare dhe e Migracionit**, sipas parashikimeve të nenit 20 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar).

U administrua përgjigje me shkrim nga drejtoria e policisë, si dhe u administrua, sipas ligjit dëshmia përpara komisionit të Drejtorit të Kufirit.

10.1.3. Detyrat e kryera **nga Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës (Komisionari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale)**, sipas parashikimeve të nenit 19/7 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar).

U administrua përgjigje me shkrim nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe u administrua, sipas ligjit dëshmia e Komisionerit përpara komisionit.

10.1.4. Detyrat e kryera **nga Personi i ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave**, sipas parashikimeve të nenit 19/8 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar).

U administrua akti, urdhër i DPPSH është një person i ngarkuar për këtë qellim.

10.1.5. Detyrat e kryera **nga Autoritetet Kompetente**, (strukturat operationale të Policisë së Shtetit; Shërbimi Informativ i Shtetit; Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes; Drejtoria e Përgjithshme e Doganave; Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave), sipas parashikimeve të nenit 19/5 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar).

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, rezultoi se përveç rasteve të përcaktuara në pikën 3, të nenit 19/5 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar), mund të përdorin rezultatet e përpunimit të të dhënave të pasagjerit vetëm nëse vlerësojnë që përdorimi i tyre shërben për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave të tjera penale.

10.1.6. Detyrat e kryera **nga Autoritetet Përgjegjëse**, (Policia Kufitare dhe të Migracionit, autoritetit doganor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor) sipas parashikimeve të nenit 3 të ligjit 71/2016 (i ndryshuar), në zbatim të strategjisë operationale dhe teknike.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve përgjegjëse, (Policia Kufitare dhe të Migracionit, autoritetit doganor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor) përpara komisionit, rezultoi se nuk ka një strategji operacionale edhe teknike të integruar sipas frymës së ligjit.

10.1.7. Institucionet që konsultojnë sistemin TIMS në Republikën e Shqipërisë.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, institucionet që konsultojnë sistemin TIMS janë, Struktura të Policisë së Shtetit sipas detyrave funksionale, Prokurorë të Prokurorisë të Përgjithshme dhe të rretheve, Prokurorë të SPAK, Hetues dhe OPGJ të BKH, oficerë doganorë, konsuj të RSH, Pastrimi i parave, SHISH.

10.1.8. Sinjalizimet nga ana e Drejtorit të Departamentit për Teknologjinë e Informacionit, z. Ervin Muça drejtuar eprorëve të tij për kryerjen e backup (kopjo rezervë) të materialeve të sistemit TIMS.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, referoi se nuk ka marrë njoftim paraprak nga DTI për këtë backup (kopje rezervë).

10.1.9. Kuadrin ligjor me të cilin ka vepruar Drejtori i Departamentit për Teknologjinë e Informacionit, z. Ervin Muça drejtuar eprorëve të tij për kryerjen e backup (kopjo rezervë) në mënyrë manuale të materialeve të sistemit TIMS.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, në manualet dhe procedurat të cilat normojnë punën e Departamentit për Teknologjinë e Informacionit nuk parashikohet në asnjë pjesë të saj mënyra se si kryhet një backup (kopje rezervë) manualisht. Si do qoftë nevoja për krijimin e një kopjeje backup manualisht dhe ruajtja e saj offline për shkak të ruajtjes nga sulmet kibernetike është identifikuar nga ana e DTI me atë të Memo që në Nëntor 2021.

10.1.10. Kryhet backup i sistemit TIMS në mënyrë automatike, dhe kur janë rastet e specifikuara nga ligji dhe/ose akteve nënligjore që backup duhet të kryhet në mënyrë manuale.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, po kryhet backup (kopje rezervë) e sistemit TIMS kryhet automatikisht çdo natë rreth orës 00:30. Procedurat e DTI nuk normojnë raste kur duhet të kryhet një backup në mënyrë manuale.

10.1.11. Proceduren ligjore që ndiqet për kryerjen e një backup në mënyrë manuale dhe ku ruhen këto të dhëna, personat përgjegjës për kryerjen e këtij veprimi.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, – Procedurat e DTI nuk normojnë raste kur duhet të kryhet një backup në mënyrë manuale, vendin e ruajtjes së këtyre të dhënave apo personat përgjegjës për kryerjen e këtij veprimi. Nën këto kushte me ane të këtij raporti e referojmë si një parashikim konkret që duhet vendosur në ligj.

10.1.12. Backup (kopjo rezervë) e fundit, periudhen që është realizuar nga ana e Departamentit për Teknologjinë e Informacionit/apo cdo institucion tjetër që mund ta ketë kryer, duke specifikuar qëllimin dhe mënyrën e sigurisë që është proceduar. Organet dhe funksionarët publikë të ngarkuar me administrimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave të sistemit TIMS.

Nga dëshmitë e marra nga titullaret e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, backup i fundit i sistemit TIMS është kryer automatikisht. Qëllimi i këtij backup (kopje rezervë) është si një garanci e shtuar për rikthimin e të dhënave të sistemit në rast nevojë, si pasojë e dëmtimit të bazës së të dhënave të sistemit TIMS. Duhet theksuar se backup (kopja rezervë) dhe baza e të dhënave të TIMS aktualisht ndodhen në të njëjtin server. Struktura e cila vëren në qoftë se procesi i krijimit të backup është ekzekutuar në kohën e duhur është Sektori për Bazat e të Dhënave në DTI. Struktura për ruajtjen e të dhënave në cilësinë e tyre janë Drejtoria për Teknologjinë e Informacionit dhe Drejtoria e Qendrës së Përpunimit dhe Ruajtjes së të Dhënave.

10.1.13. Ndërhyrje/deformime në të dhënat e data base të sistemit TIMS.

Nga dëshmitë e marra nga titullarët e autoriteteve kompetente, përpara komisionit, kryesisht në gjithë informacionin që disponon Policia e Shtetit, nuk ka asnjë indikacion, që tregojnë se të dhënat e sistemit TIMS mund të kenë pësuar ndërhyrje/deformime.

11. Fakte dhe Detaje të Rezultuara nga aktet e administruara në këtë hetim

11.1 Është fakt që u mbështet nga dëshmitë edhe hetimi se në datën 02-08-2023, Ervin Muca dhe Besjon Tanuzi me ndihmën e personave të jashtëm të pa-autorizuar kanë tentuar të bëjnë eksportim të të dhënave të sistemit TIMS.

11.2 Është fakt që u mbështet nga dëshmitë edhe hetimi se Agjencia e Mbikëqyrjes Policore e vene në dijeni me e-mail për zhvillimet në datën 02-08-2023, ora 22.54 të Ervin Muca dhe Besjon Tanuzi me ndihmën e personave të jashtëm të pa-autorizuar kanë tentuar të bëjnë eksportim të të dhënave të sistemit TIMS. Kjo Agjenci ka nisur menjëherë veprimet hetimore edhe ka dokumentuar veprimet duke i referuar faktin penal prokurorit për hetimin e kësaj çështje.

11.3 Është fakt që u mbështet nga përgjigje e përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe krimin të organizuar edhe hetimi, se pranë këtij organi hetimor nuk është regjistruar hetim penal për ngjarjen e datës 02-08-2023, të veprimeve të Ervin Muca dhe Besjon Tanuzi, të cilët me ndihmën e personave të jashtëm të pa-autorizuar kanë tentuar të bëjnë eksportim të të dhënave të sistemit TIMS. Por organi SPAK ka dhënë ndihmesën me ekspertizën e specialisteve për ekspertizën e provave digjitale për ngjarjen.

11.4 Është fakt, që u mbështet nga përgjigja e përcjellë nga Komisionari për Mbrojtjen e të Dhënave personale në kuadër të ligjit 71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", dëshmia edhe hetimi, se janë plotësuar, kërkesat e imponuara në ligj për mbrojtjen e të dhënave edhe transmetimit të të dhënave në kufi.

11.5 Është fakt që u mbështet nga përgjigja e përcjellë nga AKSIK, (shkresa nr.2249 prot, date 24-04-2024), dëshmia edhe hetimi, se sistemi TIMS nuk përfshihet në listën e sistemeve të akredituara

per trajtimin e informacionit te klasifikuar, nuk janë kryer inspektive në departamentin e IT-se se policisë, per shkak te mos akreditimit te sistemit. Ervin Muca ka plotësuar kërkesën per CSP ne datën 21-08-2023. Ndërkohë qe me vendimin 147 date 22-04-2024 , AKSIK ka bere refuzimin e pajisjes me CSP.

11.6 Është fakt qe u mbështet nga përgjigje e përcjellë nga Prokuroria e Gjykatës se Shkalles se pare e juridiksionit te përgjithshëm edhe hetimi, se pranë këtij organi hetimor është regjistruar hetim penal per ngjarjen e datës 02-08-2023, te veprimeve te Ervin Muca dhe Besjon Tanuzi, te cilët me ndihmën e personave te jashtëm te pa-autorizuar kane tentuar te bëjnë eksportim te te dhënave te sistemit TIMS. Por organi SPAK ka dhënë ndihmesën me ekspertizën e specialisteve per ekspertizën e provave digjitale per ngjarjen.

11.7 Është fakt qe u mbështet nga aktet e përcjella nga Drejtoria e Policisë, (shkresa nr.1535/1 prot, date 26-04-2024), per sistemin TIMS, se është miratuar edhe zbatohet akti “Rregullore per procedurat standarde te teknologjisë dhe informacionit”, akt, i Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1057, datë 15.11.2021. Ky akt rezulton, se ka dale ne zbatim te nenit 255 te VKM nr.750 datë 16.09.2015, “Rregullore e Policisë së Shtetit”, te cilën e citojmë me poshtë:

Neni 255

Nxjerrja dhe miratimi i akteve administrative

Drejtori i Policisë së Shtetit miraton procedura standarde të punës, në zbatim të kësaj rregulloreje.

11.7.1 Konstatim - Rezultoi gjate këtij hetimi se Drejtori i policisë se shtetit, ka miratuar procedura standarde te punës ne zbatim te Rregullores, se miratuar me VKM nr.750 date 16-09-2015.

11.8 Është fakt qe u mbështet nga aktet e përcjella nga Drejtoria e Policisë, per sistemin TIMS, se është miratuar edhe zbatohet akti “Per dhënien e te drejtës dhe mënyrës se përdorimit te llogarive ne sistemet e teknologjisë se informacionit ne policinë e shtetit”, akt, i Miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.143, datë 04-02-2022. Ky akt rezulton, se ka dale ne zbatim te nenit 255 te VKM nr.750 datë 16.09.2015, “Rregullore e Policisë së Shtetit”, te cilën e citojmë me poshtë:

Neni 255

Nxjerrja dhe miratimi i akteve administrative

Drejtori i Policisë së Shtetit miraton procedura standarde të punës, në zbatim të kësaj rregulloreje.

11.8.1 Konstatim - Rezultoi gjate këtij hetimi se Drejtori i Policisë se Shtetit, ka miratuar procedura per dhënien e se drejtës dhe mënyrës se përdorimit te llogarive ne sistemet e teknologjisë se informacionit. Ne sipas kontrollit te thelluar edhe te kryqëzuar te akteve te vena nen dispozicion ne ketë hetim, sugjerojmë qe sistemet e teknologjisë se informacionit, qe zbatohen ne kontrollin e kufijve te jashtëm, sipas ligjit duhet te miratohen me udhëzim te Ministrit te Brendshëm dhe jo me urdhër te Drejtorit te Përgjithshëm te policisë.

11.9 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se nuk rezultoi të jetë i miratuar akti “Rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor”, me udhëzim të Ministrit të Rendit Publik, sipas rezervës ligjore të dhënë në nenin 14 të ligjit nr.8839, datë 22.11.2001 “Për Grumbullimin, Administrimin Dhe Ruajtjen E Informacionit Të Klasifikuar Policor. Ky ligj përcakton rregullat për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor, në shërbim të ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si dhe parandalimit dhe zbulimit të krimeve. Policia e Shtetit është zotëuese e informacionit të klasifikuar policor dhe e përdor atë, duke respektuar garancitë kushtetuese për lirinë dhe të drejtat e njeriut. Ky akt nënligjor i deleguar sipas ligjit tek Ministri i Rendit Publik, nuk mund të delegohet tek Drejtori i Policisë. Ky akt, duhet të kishte dale nën kuadër të parashikimeve të ligjit sipërcituar, për sa citojmë me poshtë:

Neni 2

Në kuptim të këtij ligji, informacioni i klasifikuar policor konsiderohen të gjitha aktet, dokumentet zyrtare, regjistrimet audiovizuale, kompjuterike, si dhe çdo material që ka të dhëna, të cilat lidhen me veprimtarinë e policisë, në veçanti me:

a) rendin, sigurinë publike dhe me parandalimin e luftës ndaj krimit, me të dhëna që lidhen me strukturën organike të policisë, të personelit, me veprimtaritë që lidhen me teknikat e gjurmimit policor dhe të sigurisë publike;

b) shërbimin e ruajtjes së kufirit shtetëror, organizimin dhe kryerjen e operacioneve policore, si dhe sigurimin e personaliteteve të larta shtetërore.

11.9.1 Konstatim - Citimi i ligjit me sipër përforcon rekomandimin e dhënë në pikën me lart, se “Grumbullimin, Administrimin Dhe Ruajtjen E Informacionit Të Klasifikuar Policor”, qe në këtë hetim rezultoi të jetë ndër të tjera edhe informacioni i grumbulluar, administruar, ruajtur edhe përpunuar “Për sistemin TIMS”, sipas ligjit duhet të miratohet me udhëzim të Ministrit të Brendshëm dhe jo me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

11.10. Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se nuk rezultoi të jetë i miratuar akti “Rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor”, me udhëzim të Ministrit të Rendit Publik, sipas rezervës ligjore të dhënë në nenin 132 të ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit”, publikuar në fletoren zyrtare 137/2014. Ky ligj përcakton rregullat për grumbullimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar policor, në shërbim të ruajtjes së rendit dhe të sigurisë publike, si dhe parandalimit dhe zbulimit të krimeve. Policia e Shtetit është zotëuese e informacionit të klasifikuar policor dhe e përdor atë duke respektuar garancitë kushtetuese për lirinë dhe të drejtat e njeriut. Ky akt nënligjor i deleguar tek Ministri i Rendit Publik, nuk mund të delegohet tek drejtori i policisë, andaj ky akt, duhet të kishte dale nën kuadër të parashikimeve të ligjit sipërcituar, për sa citojmë me poshtë:

Neni 132

Përpunimi i informacionit policor

1. Përpunimi i informacionit policor është procesi i grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit për nevoja të mbrojtjes së rendit e të sigurisë publike ose për nevoja të parandalimit e zbulimit të veprave penale.
2. Përpunimi i informacionit policor bazohet vetëm në të dhënat e marra në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Rregullat konkrete për realizimin e përpunimit të informacionit policor prej strukturave përkatëse, si dhe masat për ruajtjen e të dhënave e për kontrollin e kësaj veprimtarie informative përcaktohen nga Ministri.

11.11 **Konstatim** - Citimi i ligjit me sipër përforcon rekomandimin e dhënë në pikat me lart, se rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor, që në këtë hetim rezulton të jetë ndër të tjera edhe informacioni i grumbulluar, administruar, ruajtur edhe përpunuar për sistemin TIMS, sipas ligjit duhet të miratohen me udhëzim të Ministrisë së Brendshme dhe jo me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

11.12 Është fakt, që u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 5, Policia Kufitare edhe Migracionit, kryen detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Nga ana tjetër sipas ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit”, publikuar në fletoren zyrtare 137/2014, parashikohet, për sa citojmë me poshtë:

Neni 21

Struktura e kufirit dhe migracionit

1. Në përbërje të Policisë së Shtetit vepron struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit me përgjegjësi kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror, si dhe trajtimin e shtetasve të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit organizohet në nivel qendror dhe vendor me drejtim dhe kontroll vertikal.

11.12 **Konstatim** - Citimi i ligjit me sipër përforcon rekomandimin e dhënë në pikat me lart, se Policia e Kufirit, si pjesë e strukturës së policisë së shtetit ka përgjegjësi ekzekutive të kontrollit në mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Andaj sipas kualifikimit të normave ligjore të cituara në këtë raport, qartësisht rezulton fakti se, rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor, që në këtë hetim rezulton të jetë ndër të tjera edhe informacioni i grumbulluar, administruar, ruajtur edhe përpunuar për sistemin TIMS, sipas ligjit duhet të miratohen me udhëzim të Ministrisë së Brendshme dhe jo me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

11.14. Është fakt, që u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit”, publikuar në fletoren zyrtare 137/2014, parashikohet, për sa citojmë me poshtë:

Neni 136

Rregullorja e Policisë Rregullorja e Policisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

11.14 Konstatim - VKM nr.750 datë 16.09.2015, si akt normativ, rezulton se ka shërbyer si baze e mire për të identifikuar rolin e drejtorit të përgjithshëm të policisë në kontrollin për mirë zbatimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të policisë së shtetit; parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit; ecurisë në karrierë dhe menaxhimit të burimeve njerëzore; vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve disiplinore.

11.15 Është fakt, që u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.108/2014 "Për policinë e shtetit", publikuar në fletoren zyrtare 137/2014, parashikohet, për sa citojmë me poshtë:

Neni 20

Drejtoria e Policisë së Shtetit

1. Drejtoria e Policisë së Shtetit është struktura qendrore administrative dhe teknike e policisë, me seli në Tiranë.
2. Drejtoria e Policisë së Shtetit përbëhet nga struktura, sipas fushave dhe shërbimeve përkatëse.
3. Drejtoria e Policisë së Shtetit kryen këto detyra:
 - a) menaxhon veprimtarinë e Policisë;
 - b) bashkërendon veprimtarinë mes strukturave për:
 - i) hartimin dhe zbatimin e strategjive për realizimin e përgjegjësive të Policisë së Shtetit;
 - ii) hartimin dhe zbatimin e planeve për rekrutimin, arsimimin dhe trajnimin e punonjësve të policisë;
 - iii) vënien në zbatim të marrëveshjeve ndërkombëtare për çështje që lidhen me Policinë;
 - c) planifikon, drejton operacione dhe hetime në shkallë vendi;
 - ç) realizon koordinimin dhe drejtimin strategjik në raste të emergjencave, aktiviteteve kombëtare e ndërkombëtare;
 - d) kryen kërkime shkencore dhe teknologjike në fushën e sigurisë;
 - dh) përgatit studime, harton në mënyrë periodike analiza risku dhe analiza të tjera për realizimin e misionit të policisë;
 - e) informon publikun në lidhjen me zbatimin e detyrave të përcaktuara në këtë ligj;
 - ë) bashkëpunon me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit dhe struktura shtetërore për ruajtjen e rendit e të sigurisë publike, parandalimin dhe zbulimin e veprave penale dhe sigurinë kombëtare;
 - f) bashkëpunon me strukturat kombëtare, ndërkombëtare, si dhe organizatat jofitimprurëse që kanë për mision monitorimin e standardeve të respektimit të lirive dhe të drejtave të njeriut;
 - g) përpunon dhe analizon të dhënat e mbledhura nga Policia deri në masën që është e nevojshme për përmbushjen e detyrave e të funksioneve të saj;
 - gj) planifikon e menaxhon buxhetin dhe burimet e tjera financiare, infrastrukturën dhe bazën materiale teknike të Policisë Shtetit që ka në administrim;
 - h) njofton Komisionerin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për llojin e të dhënave që krijon dhe administron policia, për qëllimin e këtij ligji;
 - i) kryen detyra policore, në përputhje me këtë ligj, ligje të tjera dhe akte të dala në zbatim të tyre.

11.15.1 Konstatim - Citimi i ligjit me sipër përforcon rekomandimin e dhënë në pikat me lart, se policia e shtetit ka përgjegjësi ekzekutive të kontrollit në vetëm mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Andaj sipas kualifikimit të normave ligjore të cituara në këtë raport, ravijëzohet qartësisht fakti

se, rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor, qe ne këtë hetim rezulton te jetë ndër te tjera edhe informacioni i grumbulluar, administruar, ruajtur edhe përpunuar per sistemin TIMS, sipas ligjit duhet te miratohen me udhëzim te Ministrit te Brendshëm dhe jo me urdhër te Drejtorit te Përgjithshëm te Policisë.

11.16 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, per sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.108/2014 “Per policinë e shtetit”, publikuar ne fletoren zyrtare 137/2014, per sa citojmë me poshtë:

Neni 17

Detyrat 1.

Detyrat e Policisë së Shtetit janë:

- a) mbron jetën, shëndetin, pronën publike dhe private;
- b) ruan rendin dhe sigurinë publike;
- c) parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre;
- ç) organizon fushata ndërgjegjësuese dhe informuese, me qëllim parandalimin e kryerjes së veprave penale, si dhe rritjen e bashkëpunimit me publikun;
- d) koordinon punën me inspektoratet kompetente në fushën e ndërtimit, kontrollit të mjedisit dhe territorit, për marrjen e sanksioneve administrative dhe sanksioneve të tjera, sipas ligjit të tyre funksional;
- dh) identifikon, siguron dhe trajton në ambientet e saj, personat e arrestuar ose të ndaluar deri në caktimin e masës së sigurimit me vendim gjyqate, si dhe të dënuarve me vendim të formës së prerë në mungesë, deri në transferimin e tyre në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; e) mbikëqyr dhe drejton trafikun rrugor në rrugë për përdorim publik, në përputhje me legjislacionin rrugor;

ë) mbikëqyr dhe kontrollon kufijtë shtetërorë të Republikës së Shqipërisë;

f) kontrollon regjimin e hyrje-daljeve të të huajve, të qëndrimit, të punësimit e të trajtimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;

g) identifikon, mbron dhe referon për asistencë, pranë autoriteteve përkatëse, viktimat e trafikimit, të personave dhe dhunës në familje, veçanërisht të miturit dhe gratë;

gj) administron dhe mbron informacionin e klasifikuar, me përjashtim të rasteve kur përcaktohet ndryshe në legjislacion;

h) ruan dhe siguron personalitetet e larta shtetërore dhe të huaja, si dhe objektet e rëndësisë së veçantë;

i) merr, trajton dhe/ose referon pranë strukturave përgjegjëse, ankesat e shtetasve, në mënyrë të veçantë kallëzimet penale ose informacionet e dhëna në rrugë të ndryshme për vepra penale, si dhe kryen detyra të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;

2. Punonjësve të strukturave të tjera të zbatimit të ligjit u kërkohet të vihen në shërbim të Policisë së Shtetit gjatë ushtrimit të attributeve në funksion të detyrave institucionale të njohura nga ligji.

11.16.1 **Konstatim** - Ne leximin literal te këtij neni dallojme qarte kufirin dhe diskrecionin e detyrave te policisë ne piken (e dhe f) te nenit te sipërcituar. Ne vemendje te ketyre parashikimeve ligjore sygjerojme për këtë situatë zbatimin e parimit juridik *lex specialis derogat legi generali*, që kur dy ose më shumë norma juridike zbatohen për të njëjtën situatë faktike, norma më specifike

duhet të mbizotërojë mbi atë më të përgjithshme. Ky parim ndihmon në zgjidhjen e konflikteve ndërmjet ligjeve dhe drejton interpretimin ligjor të situatës përkatëse. Në këto kushte rekomandojmë që ndryshimet ligjore të kryhen në ligjin 71/2016, si ligji që në mënyrë specifike rregullon veprimtarinë e kontrollit të kufijve në mënyrë specifike, si dhe sygjerime të parashikohen rregullat për TIMS në parashikimet ligjore në këtë akt, si një koncept që mungon tërësisht në gjitha ligjet në fuqi sot në zbatim.

11.17. Është fakt, që u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.108/2014, neni 26, Policia e Shtetit, ka një strukturë të posaçme që këshillon Drejtorin e Përgjithshëm për politikën edhe strategjitë e policisë, e cila, sipas skanimit të gjithë korpusit ligjor të bere me këtë hetim, rezultoi, se nuk ka vepruar për të pasur të harmonizuara politikën edhe strategjitë e policisë lidhur me sistemet e integruara të kontrollit në kufijtë e Republikës së Shqipërisë. Rekomandojmë që ky Këshill të veprojë sa më parë edhe sipas ligjit për sa, parashikohet, e citojmë me poshtë:

Neni 26

Këshilli i Politikave

- 1. Në Drejtorinë e Policisë së Shtetit funksionon Këshilli i Politikave, i cili i jep orientime dhe rekomandime drejtorit të Policisë së Shtetit për të trajtuar çështje që kanë të bëjnë me politikën dhe strategjitë e policisë.*
- 2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të grupit të politikave përcaktohet me urdhër nga Drejtori i Policisë së Shtetit.*

11.18 Është fakt, që u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 1, se Policia Kufitare edhe Migracionit, kryen detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

11.19 Është fakt, që u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 3, “Menaxhimi i integruar të kufirit”, udhëhiqet nga parimi i solidaritetit, bazohet në një strategji të shkruar operacionale e teknike. Sa parasheh ligji në fuqi specifikisht e citojmë me poshtë:

Neni 3

Menaxhimi i integruar i kufirit

Për zbatimin e këtij ligji, autoritetet përgjegjëse veprojnë në përputhje me konceptin e “Menaxhimit të integruar të kufirit”, i cili udhëhiqet nga parimi i solidaritetit, bazohet në një strategji të shkruar operacionale e teknike dhe përbëhet nga elementet në vijim:

- a) kontroll kufitar (verifikim dhe mbikëqyrje), përfshirë masat e ndërmarra së bashku me të gjitha autoritetet e zbatimit të ligjit për parandalimin, zbulimin dhe hetimin e krimit ndërkufitar;*
- b) analizim i risqeve për sigurinë e brendshme dhe analizim i kërcënimeve që mund të ndikojnë funksionimin ose sigurinë e kufijve;*
- c) bashkëpunim ndërmjet agjencive, Policisë Kufitare dhe të Migracionit, autoritetit doganor, Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe të gjitha autoriteteve të*

tjera, që kanë detyra të lidhura me kufirin, përfshirë shkëmbimin e rregullt të informacionit, përmes mekanizmave ekzistues të shkëmbimit të informacionit;

ç) bashkëpunim me vendet e tjera, duke u fokusuar në veçanti në vendet fqinje dhe në ato vende të tjera, të cilat janë identifikuar nëpërmjet analizës së riskut, si vende origjine dhe transiti për imigracionin ilegal;

d) masa teknike dhe operacionale, të cilat janë të lidhura me kontrollin kufitar dhe synojnë të parandalojnë imigracionin ilegal dhe të godasin krimin ndërkufitar;

dh) kithim i shtetasve të huaj që qëndrojnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) përdorim i teknologjisë së fjalës së fundit, përfshirë sistemet e informacionit me shkallëzim të gjerë;

ë) mekanizëm i kontrollit të cilësisë për të siguruar zbatimin e këtij ligji.

11.19.1 Konstatim - Citimi i nenit 3 te ligjit 71/2016, me sipër përforcon rekomandimin e dhënë me lart, se aktet ligjore e nënligjore ne fuqi i japin policisë kufitare, përgjegjësi ekzekutive te kontrollit ne vetëm mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Sipas kualifikimit te normave ligjore te cituara me lart ne këtë raport, qartësisht provohet fakti se, rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor, qe ne këtë hetim rezulton te jetë ndër te tjera edhe informacioni i grumbulluar, administruar, ruajtur edhe përpunuar per sistemin TIMS, sipas ligjit duhet te miratohen me udhëzim te Ministrisë te Brendshëm. Nen këto kushte rezultoi e provuar nga ky hetim se një strategji e shkruar per menaxhimin e kufijve e integruar mungon tërësisht, përfshirë sistemet e informacionit me shkallëzim të gjerë, prandaj rekomandojme perpilimin e saj.

11.20 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, per sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 5, Policia Kufitare edhe Migracionit, kryen detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Nga ana tjetër sipas ligjit, parashikohet, per sa citojmë me poshtë:

Neni 5

Autoritetet përgjegjëse për kontrollin kufitar

1. Kontrolli kufitar është nën juridiksionin administrativ të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike.

2. Detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare kryhen nga Policia Kufitare dhe e Migracionit, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore.

3. Për zbatimin e këtij ligji, Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të vendosë dhe të përdorë mjete teknike, përfshirë ato teknologjike, dhe qen shërbimi, si dhe të ngrrejë pengesa për të parandaluar personat të shmangin kontrollin kufitar apo të kalojnë kufirin shtetëror jashtë pikave të autorizuarra të kalimit kufitar dhe për të zbuluar veprat penale.

4. Në pikat e kalimit kufitar, Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar të bëjë fotografi, të sigurojë imazhe video-fotografike dhe të përdorë pajisje të tjera automatike, për aq sa ato janë të nevojshme për të verifikuar identitetin e personave dhe për të parandaluar e zbuluar veprat penale, si dhe për të kapur autorët e tyre. Pajisjet, instalohen në vende të dukshme dhe publiku, informohet për praninë e tyre.

5. Policia Kufitare dhe e Migracionit është e autorizuar, të zbatojë sisteme të automatizuara të verifikimit kufitar, ku, nëpërmjet përdorimit të pajisjeve elektronike, mbliidhen të dhëna për identifikim dhe për qëllim të verifikimit kufitar të automatizuar.

6. Policia Kufitare dhe e Migracionit ka në dispozicion burime njerëzore, burime financiare, pajisje dhe teknologji të përshtatshme, të nevojshme për kryerjen e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes së kufirit shtetëror, në mënyrë të tillë që të sigurojë një nivel të efektshëm, të lartë dhe uniform të kontrollit në kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

11.20.1 **Konstatim** - Citimi i nenit 5 te ligjit 71/2016, me sipër përforcon rekomandimin e dhënë me lart, se aktet ligjore e nënligjore ne fuqi i japin policisë kufitare përgjegjësi ekzekutive te kontrollit ne vetëm mbikëqyrjen e kufirit shtetëror. Ndaj sipas kualifikimit te normave ligjore te cituara me lart ne këtë raport, por edhe me poshtë ravijëzohet qartësisht fakti se, rregullat e ruajtjes, administrimit, klasifikimit dhe e drejta e dhënies së autorizimit për shfrytëzim të informacionit të klasifikuar policor, qe ne këtë hetim rezulton te jetë ndër te tjera edhe informacioni i grumbulluar, administruar, ruajtur edhe përpunuar per sistemin TIMS, sipas ligjit, duhet te miratohen me udhëzim te Ministrisë te Brendshme.

11.21 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, per sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 19/1, Policia Kufitare edhe Migracionit, kryen detyrat e verifikimit kufitar dhe mbikëqyrjes kufitare, e cila vepron në përputhje me detyrimet e përcaktuara në këtë ligj dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Nga ana tjetër sipas ligjit parashikohet, per sa citojmë me poshtë:

Neni 19/1

Njësia e Informacionit të Pasagjerit dhe baza e të dhënave të pasagjerit

1. Njësia e Informacionit të Pasagjerit, në vijim "NIP", kryen grumbullimin, përpunimin, shkëmbimin dhe shpërndarjen e të dhënave të pasagjerit.

2. NIP-i administron bazën e të dhënave të pasagjerit dhe regjistron, të paktën, veprimet e përpunimit të të dhënave, që kanë të bëjnë me:

- a) grumbullimin;
- b) ndryshimin;
- c) konsultimin;
- ç) shpërndarjen/shkëmbimin kombëtar dhe ndërkombëtar;
- d) fshirjen/shkatërrimin;
- dh) anonimizimin dhe zbulimin e të dhënave.

3. Regjistrimet e konsultimit dhe të transmetimit të të dhënave duhet të dokumentojnë arsyen e kryerjes së këtyre veprimeve, datën dhe identitetin e personit që është njohur ose ka shpërndarë të dhënat e pasagjerit, si dhe identitetin e marrësve të të dhënave.

4. Regjistrimet e të dhënave të pikës 2, të këtij neni, vendosen në dispozicion të personit të ngarkuar për mbrojtjen e të dhënave dhe Autoritetit Kombëtar Mbikëqyrës, për të mundësuar monitorimin e të gjithë veprimitarisë së përpunimit, sipas legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Rregullat për organizimin, funksionimin e NIP-it, si dhe për përdorimin e aksesin në bazën e të dhënave të pasagjerit përcaktohen në rregulloren për përpunimin e të dhënave të regjistrimit të rezervimit të pasagjerit.

11.22 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 19/3, sa citojmë me poshtë:

Neni 19/3

Përpunimi i të dhënave të pasagjerit

1. Të dhënat e regjistrit të rezervimit të pasagjerit, sipas pikës 2, të nenit 19/2, të këtij ligji, grumbullohen dhe përpunohen nga NIP-i, si dhe shpërndahen apo shkëmbehen me autoritetet kompetente, me qëllimin e vetëm parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprave të parashikuara nga nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83, 86, 87, 88, 88/a, 89/a, 101, 102, 102/a, 103, 104, 109, 109/a, 109/b, 109/c, 110/2, 110/a, 110/b, 110/c, 111, 114, 117/2 dhe 3, 128/b/2 dhe 3, 138/a, 139, 140, 141, 141/a, 143, 143/a, 143/a/1, 143/a/2, 143/a/3, 143/a/4, 143/b, 144, 145, 146, 149/a, 164, 164/a, 164/b, 186, 186/a, 187, 188, 189, 190, 192/b, 201, 202, 206/a, 206/b, 244, 244/a, 245, 245/1, 259, 259/a, 260, 278/a, 282/a, 282/c, 283, 283/a, 284, 284/a, 284/c, 284/ç, 287, 288/a/2, 293/a, 293/b, 293/c, 295/a/2, 298, 319, 319/a, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/e, 333, 333/a, të veprave penale me qëllime terroriste, që parashikohen nga kreu VII, i Kodit Penal, si dhe krimet që përfshihen në juridiksionin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare.
2. Informacioni paraprak për pasagjerin, sipas shkronjës "ë", të pikës 2, të nenit 19/2, shpërndahet nga NIP-i pranë autoriteteve përgjegjëse për kontrollin kufitar, me qëllim parandalimin e migracionit të paligjshëm dhe përmirësimin e kontrollit kufitar.
3. Autoritetet kompetente, bazuar në parimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe mbrojtjes së të dhënave personale, nuk duhet të marrin asnjë vendim që ka efekte të pafavorshme mbi subjektin e të dhënave, vetëm mbi bazën e përpunimit të automatizuar të të dhënave të pasagjerit.

11.23 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, për sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 19/5, sa citojmë me poshtë:

Neni 19/5

Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente, të cilat kanë të drejtë të kërkojnë, të konsultojnë, të marrin të dhënat e pasagjerit ose rezultatet e përpunimit të tyre, me qëllim parandalimin, zbulimin, hetimin e ndjekjen penale të veprave penale sipas nenit 19/3, të këtij ligji, janë:
 - a) strukturat operacionale të Policisë së Shtetit;
 - b) Shërbimi Informativ i Shtetit;
 - c) Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes;
 - ç) Drejtoria e Përgjithshme e Doganave;
 - d) Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.
2. Autoriteti kompetente, sipas pikës 1, të këtij neni, caktojnë përfaqësues të tyre pranë NIP-it.
3. Autoritetet kompetente përpunojnë të dhënat e pasagjerit, me qëllim përmirësimin e kontrollit kufitar, parandalimin e migracionit të paligjshëm, si dhe parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale, të krimeve të parashikuara në pikën 1, të nenit 19/3, të këtij ligji, dhe sipas rregullave të përcaktuara në rregulloren e përpunimit të të dhënave të regjistrit të rezervimit të pasagjerit.
4. Autoritetet kompetente, përveç rasteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij neni, mund të përdorin rezultatet e përpunimit të të dhënave të pasagjerit vetëm nëse vlerësojnë që përdorimi i tyre shërben për parandalimin, hetimin, zbulimin apo ndjekjen penale të veprave të tjera penale.

11.24 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, per sistemin TIMS, se sipas ligjit nr.71/2016, neni 24, sa citojmë me poshtë:

Neni 24

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë vendim në zbatim të pikës 2, të nenit 6; të pikës 6, të nenit 11; të pikës 10, të nenit 14; dhe të pikës 5, të nenit 16, të këtij ligji.

2. Ngarkohen ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin udhëzim të përbashkët në zbatim të pikës 3, të nenit 20, të këtij ligji.

3. Ngarkohet ministri përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzim në zbatim të pikës 9, të nenit 14, dhe të pikës 2, të nenit 23, të këtij ligji.

11.24.1 Konstatim- Citimi i nenit 24 te ligjit 71/2016, sipas hetimit te kryer dhe per qëllime te këtij raporti na pasqyron qartë faktin, qe ne kuadër te parashikimeve te nenit te sipër cituar Ministri i Brendshëm ka vepruar brenda afatit shterues ligjor per realizimin e rezervës ligjore plotësisht.

11.25 Është fakt, qe u mbështet nga aktet e përcjella pranë këtij Komisioni, per sistemin TIMS, se sipas ligjit nr. 108/2014 “Per policinë e shtetit”, publikuar ne fletoren zyrtare 137/2014, parashikohet, per sa citojmë me poshtë:

Neni 136

Rregullorja e Policisë Rregullorja e Policisë miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 150

Funksionet e veçanta

Funksionet e veçanta janë funksionet që kërkojnë njohuri specifike, të cilat nuk përfitohen në Akademinë e Sigurisë dhe plotësojnë nevojat e policisë për specialistë të fushave kompjuterike, ekonomike, juridike, shkencave të natyrës, inxhinierike, të mjedisit, xheniere, të pilotimit, sipas përshkrimeve të punës për çdo funksion të veçantë.

Neni 151

Aplikimi për konkurrim në funksione të veçanta

1. Drejtori i Policisë së Shtetit, mbi bazën e nevojave, shpall periudhën e aplikimit, përshkrimin e vendit të punës, dokumentacionin e nevojshëm, fazat e konkurimit, si dhe kuotat e pranimit.

2. Aplikantit i jepet formulari “tip” i aplikimit, si dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm.

Neni 152

Dokumentacioni për konkurrim në funksione të veçanta

Aplikanti që konkurren për t’u pranuar në funksione të veçanta, në momentin e aplikimit, dorëzon në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, dokumentacionin e përcaktuar në nenin 130, të kësaj rregulloreje.

Neni 153

Verifikimi i aplikantëve në funksione të veçanta

1. Para fillimit të fazës së testimeve, aplikanti i nënshtrohet procesit të verifikimit për plotësimin e kriterëve të pranimit.
2. Verifikimi i aplikantëve bëhet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 133 dhe nenin 139, të kësaj rregulloreje.

Neni 154

Fazat e vlerësimit në funksione të veçanta

1. Aplikanti që pas verifikimit rezulton se plotëson kriteret e përcaktuara për t'u pranuar në funksione të veçanta, i nënshtrohet fazave të vlerësimit si më poshtë:
 - a) jetëshkrimi të kandidatit (vlerësohet me 10 pikë);
 - b) testimi me shkrim (vlerësohet me 60 pikë);
 - c) intervista me gojë (vlerësohet me 30 pikë).
2. Aplikanti që nuk arrin të marrë të paktën 40 pikë në testin me shkrim, nuk i nënshtrohet vlerësimit në intervistën me gojë dhe ndërpret procesin e vlerësimit.

Neni 155

Vlerësimi i aplikantëve në funksione të veçanta

1. Jetëshkrimi i aplikantit përfshin vlerësimin e arsimimit e trajnimeve të lidhura me fushën që aplikon, si dhe referencat e punëdhënësve të mëparshëm.
2. Testimi me shkrim, përfshin kontrollin e njohurive të aplikantit në fushën përkatëse.
3. Intervista me gojë, përfshin vlerësimin e njohurive dhe aftësive komunikuese, përvojën profesionale të fushës përkatëse, si dhe motivimin personal.
4. Aplikanti vlerësohet nga Komisioni i Vlerësimit, i përbërë nga Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (Kryetar), titullari i strukturës për funksionin konkurrues (anëtar), si dhe eksperti i fushës përkatëse, (anëtar).
5. Komisioni, në përfundim të fazave të vlerësimit të aplikantëve, harton listën e rezultateve, sipas rendit zbritës. 6. Numri i aplikantëve fitues është i barabartë me numrin e funksioneve të lira, të shpallura për konkurrim në fillim të procesit. 7. Në qoftë se asnjë nga kandidatët nuk merr 60% të pikëve, atëherë Komisioni i Vlerësimit vendos përfundimin e konkurrimit, pa asnjë fitues të përzgjedhur. 8. Në kushtet e rezultatit pa asnjë fitues, Drejtori i Policisë së Shtetit vendos për rihapjen e procedurës së konkurrimit. 9. Drejtorja e Burimeve Njerëzore, shpall në ëb-site-in e Policisë së Shtetit, listën e aplikantëve fitues. 10. Aplikanti i shpallur fitues, kryen kualifikimin në Akademinë e Sigurisë dhe pas përfundimit të tij, pranohet në Policinë e Shtetit, i jepet grada korresponduese e funksionit të veçantë për të cilin ka konkurruar, dhe emërohet në detyrë nga Drejtori i Policisë së Shtetit. 11. Punonjësi i policisë, i pranuar në funksione të veçanta, nuk ka të drejtë të konkurrojë për ngritje në gradë/detyrë, apo të transferohet në funksione të tjera policore, për një periudhë 6 vjeçare.

11.25.1 **Konstatim** - VKM nr. 750 datë 16.09.2015, si akt normativ, rezulton se ka shërbyer si baze e mire për të identifikuar rolin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në kontrollin për mirë zbatimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e marrëdhënieve brenda dhe jashtë strukturave të policisë së shtetit; i parimeve, standardeve dhe normave që rregullojnë sjelljen profesionale dhe etike të punonjësit të policisë, gjatë dhe jashtë shërbimit; ecurisë në karrierë dhe menaxhimin të burimeve njerëzore; i vlerësimit të performancës së strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe rregullave për disiplinën dhe procedurave që ndiqen në rastin e shkeljeve

disiplinore. Megjithëse me rastin e përzgjedhjes së drejtorit të IT nuk u dha asnjë shpjegim bindës, perse ka ndodhur shkelje e parashikimeve të VKM se sipër cituar.

KREU IV

12. Teknika e Vlerësimit të Komisionit

12.1 Bazuar mbi sa dëshmuar aktet, të kryqëzuara me dëshmitë e dëshmitarëve të thirrur, sipas informacionit të përfutur, ky komision me anë të këtij raporti, adreson rekomandime të qarta për organet kompetente dhe përgjegjëse, për çështjet e sistemit TIMS edhe metodat edhe procedurat në kontrollin kufitar në kufi të Shqipërisë.

12.2 Komisioni, nëpërmjet hetimit të ngjarjes, si dhe veprimtarisë së rregulluar të institucioneve të përcaktuara nga ligji, ka mbërritur në përfundim të hetimit, edhe në këto kushte me këtë raport, referon si propozime, rishikimin e ligjit, si dhe nxjerrjen e përgjegjësisë institucionale.

12.3 Në rishikimin e të gjitha çështjeve, fakteve, dëshmiave, akteve ligjore e nënligjore mbi mënyrën se si janë zbatuar e harmonizuar, kërkesat e ligjit nga çdo institucion i përfshirë edhe zbatues në këtë hetim do të jenë pjesë e këtij raporti, gjetjet dhe përfundimet e përfutura.

IV. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

13. KONKLUZIONE

13.1 *Menaxhimi i sistemit TIMS dhe kontrolli i kufijve*

13.1.1 Nga ky hetim Komisioni arin në konkluzionin e domosdoshmërisë për një rishikim të kuadrit ligjor. Nevojitet harmonizimi i ligjit:

i.Nr. 8792 datë 10.05.2001 “Për krijimin e Qendrës së Përpunimit të të Dhënave”

ii.Nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar”

iii.Nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar

13.2 Përgjatë këtij hetimi në komisionin hetimor parlamentar për sistemin TIMS, pas hetimit të plotë edhe të kryqëzuar të të gjitha provave të administruara, rezultuan qartazi problematikat në zbatimin e akteve ligjore edhe nënligjore.

13.3 Nevojitet të kryhet rishikimi tërësor i veprimtarisë operative të të gjitha strukturave të policisë me sistemin TIMS në kuadër të konstatimeve të këtij raporti, të cilat duhet të adresohen sa më parë në formën e legjislacionit, i cili do t'i nënshtrohet shqyrtimit në parlament.

13.4 Aktet nënligjore në fuqi për sistemin TIMS duhen rishikuar tërësisht për mbrojtjen e të dhënave për sistemin TIMS ku të përfshihen në të gjitha nivelet kontrollet, si dhe të miratohen rregulla ku rregullohen kompetencat dhe llogaridhënie në çdo nivel.

14. REKOMANDIME

14.1. Ky hetim konfirmoi, problematiken me sistemin TIMS në disa drejtime të cilat, jo të gjitha lidheshin me procedurën e ndjekur në kontrollet kufitare. Këto problematika kërkojnë:

a- ndryshimin e ligjit 71/2016 “Për kontrollin kufitar”

b- nxjerrjen e akteve nënligjore për menaxhimin dhe funksionimin e sistemit TIMS,

c- përzgjedhjen, rekrutimin, dhe kualifikimin e stafit që monitoron, mirëmban, edhe përditëson sistemin TIMS,

d- certifikimit e akreditimit AKSIK të programeve kompjuterike, që mirëmbajnë edhe përditësojnë sistemin TIMS.

14.2 Rekomandojmë, ndërtimin e një strategjie të shkruar operacionale e teknike në përputhje me konceptin e “Menaxhimit të integruar të kufirit”, midis autoriteteve përgjegjëse, sipas parashikimeve të nenit 3 të ligjit 71/2016.

14.3 Është thelbësore, që çdo organ i varësisë së ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike, përgjegjëse për kontrollet kufitare edhe sistemin TIMS, t’i nënshtrohet llogaridhënies së detajuar dhe masave mbrojtëse për mbrojtjen e të dhënave, në mënyrë periodike.

14.4 Të gjitha aktivitetet e përbashkëta të kontrollit kufitar, përfshirë edhe testimet e certifikimit e sistemeve TIMS të zbatuara në Shqipëri, duhet t’i nënshtrohen mbrojtjes efektive të të dhënave.

14.5 Në rekomandojmë, përcjelljen e ndryshimeve ligjore brenda 6 muajve nga miratimi i këtij raporti në kuvend, si dhe mirëpresim që në draft-propozim të jenë inkuadruar tërësisht sugjerimet e rekomandimet e dhëna në këtë raport.

14.6 Konkluzionet e këtij raporti që i përkasin hetimit, me provat që janë administruar e çojnë komisionin në këto konkluzione, si dhe propozime për zgjidhjen e çështjes, përfshirë edhe masat për personat përgjegjës, përmbyllin hetimin.

14.7 Në këtë hetim është prodhuar ky raport përfundimtar, i cili shoqërohet edhe me a- planin e hetimeve dhe b-rekomandimet përfundimtare.

14.8 Komisioni hetimor për sistemin TIMS me marrjen e këtij raporti të përgatisë dhe miratojë vendimin përfundimtar të hetimit, së bashku me mendimin e pakicës (nëse do të ketë).

14.9 Përcjelljen e raportit përfundimtar të miratuar me vendim të komisionit Kuvendit.

14.10 Përcjelljen e rekomandimeve autoriteteve përgjegjëse, sipas sugjerimeve të rekomanduara në këtë raport.

(MENDIMI I PAKICËS PARLAMENTARE)

P Ë R M B A J T J A

HYRJE

- I. REKRUTIMI I STRUKTURËS SË IT DHE KRIMIT KIBERNETIK**
 - A. DEPARTAMENTI I IT-SË**
 - B. DREJTORIA E HETIMIT TË KRIMIT KIBERNETIK**

- II. NDËRHYRJA NË SISTEMIN TIMS NË DATAT 2-3 GUSHT 2023**
 - A. PREZANTIM I SISTEMIT TIMS**
 - B. NDËRHYRJA NË SISTEM**
 - C. REAGIMI POST-NDËRHYRJE**

- III. HAKERIMI I SISTEMIT TIMS**

- IV. AKSESI I PAAUTORIZUAR NË SISTEMIN TIMS**

- V. VËNIA NË DISPOZICION E TË DHËNAVE TË TIMS GRUPEVE KRIMINALE**

- VI. MOSREGJISTRIMI I PERSONAVE ME REKORDE KRIMINALE NË TIMS**

- VIII. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE**

IX. REKOMANDIME

HYRJE

1. Në datën 21.03.2024, Kuvendi i Shqipërisë, me kërkesë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, miratoi vendimin nr. 20/2024 “Për Ngritjen e Komisionit Hetimor të Kuvendit për Trajtimin e të Dhënave TIMS”.

2. Sipas vendimit nr. 20/2024, Komisioni Hetimor Parlamentar kishte për objekt:

- (i) shqyrtimin e çështjeve lidhur me kontrollin e veprimtarisë së institucioneve të ngarkuara me mbrojtjen e sistemit TIMS; dhe
- (ii) vlerësimin e nevojës për marrjen e masave administrative apo ndërhyrjet ligjore në legjislacionin përkatës.

3. Komisioni do të ushtronte veprimtarinë për një afat 4-mujor nga miratimi i këtij vendimi. Për shkak se Komisioni nuk e kishte ezauruar të plotë veprimtarinë e tij dhe ekspertët kërkuar më shumë kohë për përgatitjen e raportit përfundimtar, përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike kërkuar zgjatjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor për një periudhë 2-mujore, **kërkesë e cila u refuzua nga përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste pa ndonjë justifikim të arsyeshëm.**

4. Me vendimin nr. 20/2024, Kuvendi miratoi përbërjen e Komisionit me 15 anëtarë të përhershëm, nga të cilët kryetari dhe 6 (gjashtë) anëtarë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe 8 (tetë) anëtarë përfaqësues të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, si dhe 4 anëtarë zëvendësues, 2 përfaqësues të PD-së dhe 2 përfaqësues të PS-së. Përbërja e Komisionit ishte si më poshtë:

1. Ervin Salianji	Kryetar (PD)
2. Toni Gogu	Nënkryetar (PS)
3. Nasip Naço	Anëtar (PS)
4. Blerina Gjylameti	Anëtare (PS)
5. Etilda Gjonaj	Anëtare (PS)
6. Xhemal Qefalia	Anëtar (PS)
7. Antoneta Dhima	Anëtare (PS)
8. Bardhyl Kollçaku	Anëtar (PS)
9. Denis Deliu	Anëtar (PS)

10. Lindita Metaliaj	Anëtare (PD)
11. Lefter Gështenja	Anëtar (PD)
12. Asllan Dogjani	Anëtar (PD)
13. Ramadan Likaj	Anëtar (PD)
14. Luan Baçi	Anëtar (PD)
15. Elda Hoti	Anëtare (PD)

Anëtarët zëvendësues:

1. Eduart Ndreca	Anëtar zëvendësues (PS)
2. Laert Duraj	Anëtar zëvendësues (PS)
3. Bledion Nallbati	Anëtar zëvendësues (PD)
4. Isuf Celaj	Anëtar zëvendësues (PD)

5. Gjatë periudhës së veprimtarisë së tij, Komisioni Hetimor zgjodhi sekretarin e tij, zotin Xhemal Qefalia, miratoi Planin Paraprak të Hetimeve dhe mblodhi dokumentet e provat e nevojshme, sipas kërkesave të anëtarëve të Komisionit. **Nga ana e përfaqësuesve të Grupit Parlamentar të PS-së pati zvarritje të dërgimit të kërkesave për informacion** me pretendimin se sipas ndryshimeve ligjore, marrja e provave duhet të bëhet me vendim të ndërmjetëm, ndryshe nga praktika e mëparshme që marrja e provave bëhet me kërkesë të secilit anëtar pa votim. **Këshilli i Ministrave refuzoi të vinte në dispozicion të Komisionit Hetimor informacionet e kërkuara,** ndërsa u administruan përgjigjet e Ministrisë së Brendshme, Policisë së Shtetit, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Shërbimit Informativ Shtetëror, Autoritetit Kombëtar të Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Prokurorisë së Posaçme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

6. Në datën 08.05.2024, Komisioni Hetimor miratoi Planin e Hetimit dhe listën e dëshmitarëve. Nga data 15 Maj deri më 15 Korrik 2024, Komisioni zhvilloi seancat dëgjimore me dëshmitarët, përkatësisht u thirrën dhe dëshmuan Ministri i Brendshëm Taulant Balla, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Besnik Dervishi, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit Muhamet Rrumbullaku, ish-Drejtori i Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit Ervin Muça, ish-Shefi i Sektorit të Serverave në Policinë e Shtetit Ardit Muço, ish-Drejtori i Sistemeve në Policinë e Shtetit Besjon Tanuzi, Drejtorja e Hetimit të Krimin Kibernetik në Policinë e Shtetit Ervina Gjana, Drejtori i Departamentit të Policisë Kriminale në Policinë e Shtetit Neritan Nallbati, Drejtori i Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit Zef Laska, Drejtori i Sistemeve në Policinë e Shtetit Enri Ndoni, Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin Saimir Boshnjaku, Drejtorja e Shërbimit Informativ Shtetëror Vlora Hyseni, Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Florian Sulejmani, ish-Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore Ardi Veliu, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave Genti Gazheli, Drejtori i AKU-së Edmond Rrushi, Kryeinspektorja e ISHSSH Luneda

Sufali, Drejtori i Agjencisë së Inteligjencës dhe Mbrojtjes Ardian Bali, Drejtori i Parandalimit të Pastrimit të Parave Ervin Koçi dhe ish-Drejtori i AKSIK Dorian Tola.

7. **Anëtarët, përfaqësues të Partisë Socialiste, refuzuan të thërrisnin për të dëshmuar kryeministrin Edi Rama**, megjithëse në dokumentacionin e administruar dhe dëshmitë e marra emri i tij u përmend në mënyrë të përsëritur si person që kishte dijeni për rrethanat e objektit të hetimit, si dhe për deklaratat e bëra publikisht nga ana e tij. Po ashtu, **anëtarët e mazhorancës refuzuan të thërrisnin për të dëshmuar ish-ministrin e Brendshëm Bledar Cuçi**, i cili kishte pasur një rol të rëndësishëm për krijimin e funksioneve të veçanta për Drejtorin e Departamentit të IT dhe Drejtorin e Drejtorisë së Krimit Kibernetik në Policinë e Shtetit. Duke përdorur sërish argumentin e ndryshimeve ligjore dhe forcën e kartonit, **anëtarët e mazhorancës vendosën që dëshmitë të merren me dver të mbyllura, megjithëse në të shumtën e rasteve dëshmitë nuk përmbanin informacione të klasifikuara sekret shtetëror**. Sjellim në vëmendje se ndryshimet e njëanshme në ligjin për komisionet hetimore u shfuqizuan nga Gjykata Kushtetuese me një vendim të shpallur në datën 9 Korrik 2024.

8. Komisioni zhvilloi 16 (gjashtëmbëdhjetë) mbledhje dhe në përfundim miratoi Raportin Përfundimtar, i cili i paraqitet Kuvendit (seancës plenare) për miratim.

9. Komisioni, gjatë të gjithë ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka zbatuar me përpikëri ligjin nr. 8891, datë 2.5.2002 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisioneve Hetimore të Kuvendit”, Kodin e Procedurës Penale dhe Rregulloren e Kuvendit, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore në dispozicion për mbledhjen e provave, informacioneve dhe dëshmimeve të nevojshme për përmbushjen e planit të miratuar të hetimit dhe realizimin e qëllimit dhe objektit të komisionit hetimor.

I. REKRUTIMI I STRUKTURËS SË IT DHE KRIMIT KIBERNETIK

A. DEPARTAMENTI I IT-SË

10. Në kuadër të hetimit parlamentar të kryer nga Komisioni Hetimor për Trajtimin e të Dhënave të Sistemit TIMS, u administrua dokumentacioni nga Policia e Shtetit dhe u pyetën në cilësinë e dëshmitarit drejtuesit e Policisë së Shtetit lidhur me kriteret, procedurat dhe përgjegjësitë për rekrutimin e ekipit të ri të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Policinë e Shtetit. Konkretisht nga përgjigjet e marra me shkrim, materialet shkresore dhe dëshmitë e marra në Komision rezultoi se me anë të Urdhrit Nr. 47, datë 14.04.2023, të Ministrit të Brendshëm “Për miratimin e strukturës dhe të organikës në nivel qendror, vendor dhe strukturat e vecanta të Policisë së Shtetit”, Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit, u rikonceptua dhe ristrukturua nga nivel Drejtorie në nivel Departamenti. Ky department kishte për mision përmirësimin e mëtejshëm të organizatës nëpërmjet rritjes të cilësisë së shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

11. Në shpjegimet e dhëna me shkrim nëpërmjet shkresës me 3755/2 prot., datë 26.04.2024 nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zoti Muhamet Rrumbullaku sa i përket ristrukturimit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, thuhet se nevoja e kushtëzuar nga dinamika në rritje e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe shërbimeve që ajo mundëson, si dhe për t’u përgjigjur në kohë nevojave të strukturave për informacion apo komunikim, solli domosdoshmëri për ndryshime strukturore në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, e cila ishte strukturë e vecantë e Policisë së Shtetit, në varësi të Drejtorit të Departamentit të Shërbimeve Mbështetëse. Në këtë kuadër, ngritja hierarkike e strukturës së Informacionit në nivel Departamenti, në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm, kordinuar edhe me ndryshimet strukturore përkatëse, do të mundësonte mbështetje më të madhe të këtyre strukturave në objektivat dhe nevojat e informatizimit dhe digjitalizimit të shërbimeve të administruara nga cdo strukturë e Policisë së Shtetit.

12. Drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit përgjigjet tek Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe është një punonjës policie i nivelit të lartë drejtues në Policinë e Shtetit, i cili përfaqëson skuadrën drejtuese në Policinë e Shtetit, me përgjegjësi mbikqyrëse dhe menaxhuese për të gjitha njësitë administrative në Departamentin për Teknologjinë së Informacionit. Ai është përgjegjës për studimin, projektimin, implementimin e teknologjive të reja informatike, telefonisë, pajisjeve informatike në përdorim të Policisë së Shtetit,

si dhe të monitorimit të mirëmbajtjes së tyre, me qëllim garantimin e menaxhimit total të informacionit policor.

13. Drejtori i Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit siguron mbikqyrje direkte për Sektorin e Bazës së të Dhënave, Sektorin e Projekteve, Programimit dhe Zhvillimit, Sektorin e Sigurisë Informatike, Sektorin e Serverave dhe i Aplikacioneve për Servera, Sektorin e Rrjeteve dhe Komunikimeve, Sektorin Help-Desk dhe Shërbimeve të T.I, Sektorin e Infrastrukturës Elektrike, dhe T.I, dhe Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse.

14. Vetëm dy muaj pas daljes së Urdhrit Nr. 47, datë 14.04.2023 të Ministrit të Brëndshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, u vu në lëvizje për plotësimin e pozicioneve të reja të punës të krijuara sipas këtij urdhëri. Me Relacionin Nr. 5210 Prot, datë 09.06.2023 “Për caktimin e një funksioni të veçantë në Policinë e Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka argumentuar se nisur nga situatat e krijuara kohët e fundit, për shkak të hakerimeve të sistemeve të teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit dhe jo vetëm, informacionin që administrohet në sistemet që administron Policia e Shtetit, ka lindur si nevojë ngritja e kapaciteteve për rritjen e parametrave të sigurisë informatike jo vetëm në aspektin teknik, por edhe në aspektin strukturor duke zgjeruar dukshëm fushat e përgjegjësisë.

15. Po në këtë relacion është arsyetuar mbi domosdoshmërinë që funksioni i Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të jetë funksion me gradë policore “Drejtues i Lartë”, propozim i cili ju drejtua Ministrit të Brëndshëm me anë të shkresës Nr. 5210/1 Prot, datë 09.06.2023. Në përgjigje të shkresës së mësipërme, Ministri i Brëndshëm ka nxjerrë Urdhrin Nr. 84, datë 16.06.2023, me anë të së cilit është përcaktuar se Drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është funksion i veçantë, me gradë policore “Drejtues i Lartë”. Me Urdhrin Nr. 887/1, datë 19.06.2023, “Për fillimin e aplikimeve për pranimin në funksion të vecanta në Policinë e Shtetit”, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka bërë shpalljen e aplikimeve për pozicionin e sipërpërmendur, që do të fillonin nga data 19.06.2023 deri më datë 21.06.2023. Për këtë pozicion pune aplikoi vetëm një kandidat, shtetasi Ervin Muça, i cili u shpall edhe fitues.

16. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka nxjerrë Urdhrin Nr. 1178/4, datë 23.6.2023 “Për kryerjen e kualifikimit policor për z. Ervin Muça”. Rektori i Akademisë së Sigurisë ka nxjerrë Urdhrin Nr. 295, datë 27.6.2023 “Për kryerjen e kualifikimit policor për funksione të vecanta, Drejtor në Departamentin për Teknologjinë e Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit”. Akademia e Sigurisë ka nxjerrë Urdhrin Nr. 295/1, datë 27.6.2023 “Për miratimin e orarit mësimor, për zhvillimin e trajnimit për funksione të vecanta”. Me shkresën Nr. 1622, datë 18.07.2023 është dërguar rezultati i trajnimit, shoqëruar me proces-verbal të provimit të certifikimit.

17. Me Urdhrin Nr. 1178/5 datën 17.06.2023 ose 27.06.2023, është emëruar Z. Ervin Muca në postin e Drejtorit të DTI. Data e urdhërit të emërimit të Z. Ervin Muca, u interpretua si “lapsus” nga ana e Drejtuesit të Policisë së Shtetit, në dëshminë e tij dhënë përpara Komisionit Hetimor. Shtetasi Ardit Muço, ish-Shefi i Sektorit të Serverave dhe BBC, në dëshminë e tij përpara Komisionit Hetimor, deklaroi se prezantimi i Drejtuesit të DTI ishte kryer në datë 19.06.2023, dhe këtë njoftim ja kishin dhënë kolegët e tij të Departamentit. Nga faktet dhe provat e administruara nga Komisioni Hetimor është e qartë se procedura e rekrutimit të Drejtorit të Departamentit të IT-së ishte fiktive dhe fituesi ishte paracaktuar.

18. Pavarësisht datës së saktë, urdhri i emërimit bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 40, pika 2 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe nenit 155, pika 4 të “Rregullorës së Policisë së Shtetit”, të cilat parashikojnë se personi që shpallet fitues, dhe pranohet në këto funksione, kryen kualifikimin në Akademinë e Sigurisë, dhe pas përfundimit të tij, pranohet në Policinë e Shtetit, i jepet grada korresponduese me funksionin e veçantë dhe emërohet në detyrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Referuar këtyre parashikimeve ligjore, urdhri për emërimin e Z. Ervin Muca, duhet të dilte mbas datës 18.07.2023. Pavarësisht parashikimeve ligjore të sipërpërmendura, Z. Ervin Muca, ka vazhduar ushtrimin e detyrës së Drejtorit të DTI.

19. Sipas legjislacionit në fuqi, dhe konkretisht VKM-së Nr. 188, datë 04.03.2015 “Për miratimin e Rregullave për Sigurimin e Personelit”, Ligjit Nr. 128/2021 “Për Agjensinë e Mbikëqyrjes Policore”, dhe Urdhërit Nr. 251, datë 11.02.2019 të Ministrit të Brendshëm “Për Funksionet Organike në Ministrinë e Brendshme”, për shkak të detyrës mund dhe duhet të njihen me informacion të klasifikuar, funksioni në të cilin ishte emëruar z. Ervin Muca, kërkon pajisjen me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP).

20. Referuar shkresës Nr. 2249 prot, datë 24.04.2024 të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, drejtuar Kuvendit, rezulton se kërkesa institucionale drejtuar këtij institucioni për pajisjen me CSP të shtetasit Ervin Muca, bashkëngjitur dokumentacioni verifikues, mban Nr. 2203/7 prot, datë 29.09.2023. Pyetësi i sigurisë dhe dy deklaratat shoqëruese mbajnë datën 21.08.2023. Me vendimin Nr. 147, datë 22.04.2024, AKSIK ka bërë refuzimin për pajisjen e shtetasit Ervin Muca me CSP. Pra Ervin Muca e ka ushtruar detyrën e tij si drejtues i DTI, gjatë gjithë kësaj periudhe pa qënë i pajisur me CSP, ashtu siç edhe ligji e parashikon.

21. Përveç mungesës së Certifikatës së Sigurimit të Personelit, megjithëse nga dokumentacioni i administruar në Komision, por edhe dëshmitë e marra, veçanërisht dëshmia e Drejtores së Shërbimit Informativ Shtetëror, zonjës Vlora Hyseni në datën 02.07.2024, është e qartë se Drejtori i Departamentit të IT-së duhet të pajisjet me certifikatë sigurie, për zotin Ervin Muca rezultuan edhe fakte e prova të tjera, të cilat e bëjnë tërësisht të papërshtatshëm për emërimin

në detyrë. Konkretisht, nga hetimet e kryera nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka rezultuar se ky shtetas është proceduar penalisht për falsifikim dokumentesh në vitin 2007 nga autoritetet ligjzbatuese italiane dhe në vitin 2008 i është refuzuar leja e qëndrimit. Zoti Muça nuk ka plotësuar formularin e dekriminalizimit dhe njëkohësisht rezultonte i dypunësuar si këshilltar i drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, megjithëse nuk është gjetur ndonjë produkt pune konkret i kryer në këtë funksion (shih shkresën nr. 11097 prot., datë 09.05.2024 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë). Po ashtu, zoti Muça nuk kishte asnjë eksperiencë të mëparshme në strukturat e Policisë së Shtetit apo në sistemet e saj informatike.

22. Konkluzion: Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se zoti Ervin Muça nuk përmbushte kushtet për t'u emëruar në detyrën e Drejtorit të Departamentit të IT-së. Konkretisht, ky shtetas ishte proceduar penalisht për falsifikim dokumentesh në shtetin italian në vitin 2007, ishte refuzuar leja e qëndrimit në vitin 2008, nuk kishte plotësuar formularin e dekriminalizimit, nuk kishte kryer trajnimet e detyrueshme në Akademinë e Sigurisë, nuk ishte pajisur me Certifikatën e Sigurimit të Personelit dhe ishte njëkohësisht i punësuar si këshilltar i drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, megjithëse hetimet e kryera nga Prokuroria nuk kanë gjetur ndonjë produkt konkret pune.

23. Pas marrjes së detyrës së Drejtorit të Departamentit të IT-së, zoti Muça me shkresën Nr.1315, datë 14.07.2023 ka propozuar për emërim në pozicionin Drejtor të Sistemeve në DTI, zotin Besjon Tanuzi. Me urdhrin Nr. 3133/1, datë 18.07.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ku shtetas është emëruar në detyrën e Drejtorit të Sistemeve në DTI-në e Policisë së Shtetit. Ky punësim është kryer sipas Kodit të Punës, por në kundërshtim me parashikimet e nenit 41 të Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" dhe neneve 184 dhe 185 të "Rregullorës së Policisë së Shtetit", për punësimin në funksione ndihmëse, pa kryer shpalljen e pozicionit vakant të punës, për fillimin e aplikimeve, me arsyetimin e nevojës së ngutshme për burime njerëzore në këtë departament. Gjatë dëshmisë së dhënë në Komision, zoti Muça, ashtu edhe si zoti Tanuzi pranuan njohjen e tyre të mëparshme, si dhe se kishte qënë zoti Muça që i kishte prezantuar mundësinë e punësimit në këtë pozicion. Ky shtetas ka qëndruar rreth një muaj i punësuar në këtë pozicion dhe më pas ka dhënë dorëheqje.

24. Sipas legjislacionit të sipërcituar edhe për këtë pozicion pune ka qënë e nevojshme pajisja me Certifikatë të Sigurisë së Personelit. Referuar shkresës me Nr. 2249 prot, datë 24.04.2024 të Autoritetit Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar, drejtuar Kuvendit, për këtë shtetas nuk është administruar asnjë kërkesë për t'u pajisur me CSP. Në përgjigjen e Drejtorisë së përgjithshme të Policisë së Shtetit, ky fakt justifikohet me qëndrimin për një kohë të shkurtër në detyrë të këtij shtetasi. Ky argument nuk është aspak ligjor, pasi që institucioni normalisht nuk mund të kishte informacion paraprak për kohëzgjatjen e punësimit të tij në detyrën

e Drejtorit të Sistemeve në DTI-në e Policisë së Shtetit. Ky shtetas e ka ushtruar detyrën e papajisur me CSP, në kundërshtim me parashikimet ligjore.

25. Referuar shkresës nr. 3755/2 prot., datë 26.04.2024 së Drejtorisë të Përgjithshme të Policisë së Shtetit, dokumentacioni i shtetasit Besjon Tanuzi është administruar në Sektorin e Kartotekës dhe Arkivës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit me Nr. 1315, datë 14.04.2023. Kjo do të thotë që zoti Tanuzi ka paraqitur dokumentacionin për t'u emëruar në detyrën e Drejtorit të Sistemeve në DTI-në e Policisë së Shtetit, në të njëjtën datë me daljen e urdhërit të Ministrit të Brendshëm për miratimin e strukturës së re. Edhe në rastin e zotit Tanuzi kemi të bëjmë vetëm me një kandidaturë të vetme të përcjellë nga Drejtori i Departamentit të IT-së, zoti Ervin Muça dhe pa ndjekur asnjë procedurë paraprake konkurrimi. Po ashtu, nga background-i arsimor, por edhe profesional është e qartë se zoti Tanuzi nuk kishte eksperiencë të mëparshme në Policinë e Shtetit apo sistemet informatike të kësaj të fundit.

26. Pas largimit me dorëheqje të zotit Besjon Tanuzi, megjithëse gjatë dëshmisë së tij Drejtori i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, zoti Zef Laska tha se ishte larguar për shkak të mospërbushjes së kriterëve ligjore, me shkresën Nr. 1570 Prot, datë 24.08.2023, të Drejtorit të Departamentit të Teknologjisë së Informacionit zotit Ervin Muça, është propozuar për emërim me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Sistemeve, pranë Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, Z. Enri Ndoni. Ky propozim është miratuar me Urdhrin Nr. 3228/1, datë 24.08.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë. Edhe në këtë rast, punësimi është kryer sipas Kodit të Punës, por në kundërshtim me parashikimet e nenit 41 të Ligjit Nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit" dhe neneve 184 dhe 185 të "Rregullores së Policisë së Shtetit", për punësimin në funksione ndihmëse, pa kryer shpalljen e pozicionit vakant të punës, për fillimin e aplikimeve, me asyretimin e nevojës së ngutshme për burime njerëzore.

27. Duke qenë i njëjti pozicion pune që ka mbajtur Z. Besjon Tanuzi, edhe Z. Enri Ndoni duhej të pajisej me çertifikatë sigurie. Sipas shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë Nr. 3755/2, prot, datë 26.04.2024, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, relatohet Z. Enri Ndoni ka aplikuar për pajisje me Certifikatë të Sigurisë së Personelit, por që deri në këto momente nuk është pajisur me një të tillë. Me shkresën Nr. 2249 prot, datë 24.04.2024 të AKSIK, ka informuar Kuvendin se nuk disponon asnjë kërkesë për pajisje me CSP për shtetasin Enri Ndoni. Pra, Enri Ndoni, e ka ushtruar detyrën në kundërshtim me dispozitat ligjore pasi ka qenë i papajisur me CSP.

28. Referuar shkresës Nr. 3755/2 Prot, datë 26.04.2024, të DPPSH, konstatojmë se dokumentacioni personal dhe kërkesa për punësim e paraqitur nga Z. Enri Ndoni, pas miratimit të urdhërit të pranimit dhe nënshkrimit të kontratës individuale të punës, gjendet në Sektorin e Kartotekës dhe Arkivës me Nr. E-75, datë 22.06.2023. Pra sipas kësaj shkrese, Enri Ndoni kishte dorëzuar dokumentacionin për punësim, ishte miratuar urdhëri i pranimit, kishte nënshkruar edhe kontratën e punës, një muaj më parë se të emërohej, kur kjo detyrë mbahej akoma nga Z. Besjon

Tanuzi. Ndërkohë që propozimi për emërim dhe urdhëri për emërim i Enri Ndoni, mbajnë data të një muaji më pas. Për këto mospërputhje të datave dhe numrave të protokollit të shkresave përkatëse me anë të të cilave është kryer e gjithë procedura e emërimit të këtyre drejtuesve në funksionet e mësipërme, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit deklaroi përpara Komisionit Hetimor se ato janë “lapsuse” të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

29. **Konkluzion:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor rezulton se procedurat e rekrutimit të ish-drejtorit Besjon Tanuzi dhe drejtorit aktual Enri Ndoni kanë qenë fiktive dhe me rezultat të paracaktuar. Kjo duket nga fakti që ata kanë aplikuar dokumentet për t’u emëruar në këto pozicione para krijimit të vakancës, nuk ka pasur asnjë shpallje për vendin vakant në këto pozicione dhe kanë qenë kandidaturat e vetme që i janë paraqitur për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, rezulton se zoti Tanuzi nuk kishte asnjë eksperiencë të mëparshme në Policinë e Shtetit apo sistemet e informatike të kësaj të fundit dhe nuk ishte pajisur me çertifikatë sigurie, ndërsa duket se marrëdhënia miqësore me shtetasin Ervin Muça ka qenë vendimtare për emërimin e tij.

B. DREJTORIA E HETIMIT TË KRIMIT KIBERNETIK

30. Duke ju referuar Relacionit “Për miratimin e një funksioni të vecatë në Policinë e Shtetit” me Nr. 6604 prot, datë 21.07.2023 dhe Shkresës Nr. 6604/1, datë 21.07.2023, me lëndë “Propozim për caktimin e një funksioni të vecatë në Policinë e Shtetit”, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka argumentuar se nisur nga rëndësia që ka menaxhimi dhe drejtimi i hetimeve në fushën e teknologjisë së informacionit, bazuar edhe në natyrën e punës së Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, e cila ka në fokus parandalimin nëpërmjet informimit, identifikimit, gjurmimit dhe dokumentimit të provave kryesisht digjitale, drejtuesi duhet të ketë njohuri të thelluara në shkencat kompjuterike dhe të caktohet si funksion i vecatë në Policinë e Shtetit me gradë “Drejtes i Parë”.

31. Me urdhrin e Nr. 104, datë 25.07.2023, Ministri i Brendshëm, ka urdhëruar që Drejtori i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit të jetë funksion i vecatë me gradë policore “Drejtes i Parë”.

32. Me urdhërin Nr. 1073/1, datë 27.07.2023, kanë filluar aplikimet për pranimin në funksione të vecanta në DPPSH për pozicionin Drejtor i Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, në Departamentin e Policisë Kriminale në DPPSH, me afat nga data 28.07.2023 deri në datën 31.07.2023. Për këtë pozicion kishte vetëm një aplikant që u shpall edhe fitues, Zonja Ervina Gjana. Përsëri edhe në këtë rast, për një pozicion pune kaq të rëndësishëm kandidatura e vetme ishte ajo e Ervina Gjanës.

33. Në datë 02.08.2023, me urdhrin Nr. 4836 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është pranuar në funksione të vecanta në Policinë e Shtetit, Zj. Ervina Gjana. Urdhri i emërimit bie në kundërshtim me parashikimet e nenit 40, pika 2 të Ligjit Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe nenit 155, pika 4 të “Rregullorës së Policisë së Shtetit”, të cilat parashikojnë se personi që shpallet fitues, dhe pranohet në këto funksione, kryen kualifikimin në Akademinë e Sigurisë, dhe pas përfundimit të tij, pranohet në Policinë e Shtetit, i jepet grada korresponduese me funksionin e vecantë dhe emërohet në detyrë nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Referuar këtyre parashikimeve ligjore, urdhri për emërimin e Zj. Ervina Gjana duhet të dilte mbas datës 15.09.2023, pas datës së supozuar të kryerjes së trajnimit në Akademinë e Sigurisë.

34. Në datë 03.08.2023 ka dalë urdhëri nr. 1073/2, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për kryerjen e kualifikimit në Akademinë e Sigurisë për pranimin në funksione të vecanta në Policinë e Shtetit të Ervina Gjana. Po në datë 03.08.2023 ka dalë Urdhëri i Rektorit të Akademisë së Sigurisë me nr. 339, “Për kryerjen e kualifikimit policor për funksione të vecanata për Zj. Ervina Gjana” dhe Urdhëri i Akademisë së Sigurisë Nr. 339/1, datë 03.08.2023, “Për miratimin e orarit mësimor për zhvillimin e trajnimit për funksione të vecanta në Policinë e Shtetit, Drejtor në Drejtorinë e Hetimit të Krimeve Kibernetike”. Pra në datën 03.08.2023, ditën e ngjarjes, janë nxjerrë të gjitha urdhërat përkatës si nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Akademia e Sigurisë, për kualifikim dhe trajnim të shtetasës Ervina Gjana. Me anë të shkresës nr. 2053 Prot, datë 15.09.2023, janë dërguar rezultatat e trajnimit për Zj. Ervina Gjana.

35. Në referim të shkresës nr. 3755/2 prot., datë 26.04.2024 drejtuar Kuvendit, konstatohet se dokumentacioni i punësimit të Zj. Ervina Gjana është administruar nga Komisioni i Vlerësimit dhe pas procesit të konkurimit, është administruar në dosjen personale nga Sektori i Kartotekës dhe Arkivës në DPPSH, me Nr. E-82, datë 04.07.2023, ndërkohë që aplikimet për pranim në pozicion pune kanë nisur në datën 28.07.2023. Pra, zonja Gjana ka kryer aplikimin dhe dorëzuar dokumentacionin, përpara shpalljes së vendit vakant të Drejtorit të Hetimit të Krimit Kibernetik. Gjatë dëshimsë së saj, dhënë përpara Komisionit hetimor, Zj. Ervina Gjana deklaroi se dorëzimi i dokumentacionit përpara afatit të shpalljes së vendit vakant, është kryer për shkak se i ka thënë një “mik”, emrin e të cilit nuk pranoi ta thoshte. Pra punësimi i kësaj shtetasje në këtë Departament, ka qënë i orientuar dhe udhëzuar nga një “mik” i panjohur deri më tani.

36. Vlen të theksohet fakti se, në një pozicion pune kaq të rëndësishëm sic është Drejtoria e Hetimit Kibernetik, kandidati për punësim, minimalisht duhet të kishte një eksperiencë pune për sa i përket hetimit dhe proceseve hetimore, kriter që mungonte tek shtetasja Ervina Gjana, duke ju referuar dokumentacionit dhe CV-së që ajo ka depozituar. Ky fakt u pohua edhe nga vetë ajo gjatë dëshmisë dhënë përpara Komisionit Hetimor Parlamentar. E vetmja eksperiencë e saj e mëparshme në Policinë e Shtetit ishte specialiste në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në periudhën 2010 – 2014, pra 9 vite përpara emërimit në detyrën e Drejtorit të Hetimit të Krimit Kibernetik, dhe që nuk kishte pasur ndonjë eksperiencë në hetimin e krimeve kibernetike.

37. Po ashtu, nga përmbajtja e shkresës nr. 61 prot., datë 26.04.2024 e Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, zoti Florian Sulejmani rezultoi se: “Për shtetasen Ervina Bashkim Gjana, në atë kohë Specialiste në Sektorin e Serverave, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në DPPSH, Agjencia, me shkresën Nr. 1150/1, datë 30.05.2014, ka referuar materialet proceduriale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si e dyshuar për veprën penale të “Vjedhjes”, e parashikuar nga neni 134, i K.Penal. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 6170, datë 31.10.2014, ka dërguar në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore (SHKB), Vendimin e Mosfillimit penal për material kallëzues, duke urdhëruar kthimin e sendit të sekuestruar sipas dispozitivit të këtij vendimi.”.

38. **Konkluzion:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor rezulton se procedura e ndjekur për emërimin e Drejtores së Hetimit të Krimit Kibernetik Ervina Gjana ka qenë fiktive dhe me rezultat të paracaktuar. Kjo del qartazi nga fakti se zonja Gjana ka depozituar dokumentacionin përpara shpalljes së vendit vakant, ka qenë kandidaturë e vetme, aplikimet janë hapur vetëm për dy ditë dhe emërimi është kryer përpara trajnimit në Akademinë e Sigurisë, në shkelje të përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”. Po ashtu, rezulton se zonja Gjana nuk kishte asnjë eksperiencë të mëparshme në hetimin e krimeve kibernetike, certifikata e saj e sigurisë nuk ishte konform detyrës së re dhe në vitin 2014 që përkon me largimin nga detyra e specialistes së Sektorit të Serverave në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, ishin referuar materialet proceduriale si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes”, e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

II. NDËRHYRJA NË SISTEMIN TIMS NË DATAT 2-3 GUSHT 2023

A. PREZANTIM I SISTEMIT TIMS

39. Nga përmbajtja e shkresës nr. 3755/2 prot., datë 26.04.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotit Muhamet Rrumbullaku, por edhe dëshmime të marra nga Komisioni Hetimor sa i përket historikut dhe funksionimit të sistemit TIMS rezulton se pas viteve 2000 në Policinë e Shtetit ishte shfaqur nevoja për një sistem të centralizuar me qëllim modernizimin dhe transformimin e Policisë së Shtetit Shqiptar me anë të përdorimit të teknologjisë. Në vitin 2002 nga Programi ICITAP, i Departamentit të Drejtësisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, filloi dizenjimi i sistemit TIMS në formë donacioni për Policinë e Shtetit. Implementimi i sistemit TIMS në Pikën e Kalimit Kufitar Rinas u realizua në vitin 2004, ndërsa është bërë funksional në të gjitha Pikat e Kalimit Kufitar në vitin 2010. Në vitin 2014 është kryer investimi i fundit mbi infrastrukturën fizike të serverave të bazës së të dhënave të sistemit TIMS. Përditësimi i fundit në kodin e sistemit TIMS është realizuar në vitin 2015. ICITAP e përfundoi projektin e mbështetjes për teknologjinë e informacionit të Policisë së Shtetit në vitin 2020.

40. TIMS (Total Information Management System) është Sistemi i Menaxhimit Total të Informacionit në lidhje me: (i) gjeneralitetet e shtetasve shqiptar apo të huaj, të cilët kanë regjistruar të paktën një hyrje/dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë apo kanë një dokument udhëtimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë; (ii) të dhënat e dokumenteve të identifikimit, të cilët kanë regjistruar të paktën një hyrje/dalje ose janë të lëshuara nga Republika e Shqipërisë; (iii) të dhëna për automjetet, të cilët kanë regjistruar të paktën një hyrje/dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë; (iv) informacionin e shtetasve për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë; (v) urdhër arrestimi, ndalimi, kërkimi, të dyshuar; (vi) shtetasve të kategorive Inad dhe Deportiv; (vii) njoftime (për shtetas, dokumente, automjete) në kufi nga çdo strukturë e Policisë së Shtetit; (viii) informacion mbi personat e ndaluar, arrestuar, shoqëruar; (ix) aplikimet për leje qëndrimi të personave me shtetësi të huaj (shkëputur nga TIMS në vitin 2024 me qëllim rritjen e performancës); (x) lejet e qëndrimit për personat me shtetësi të huaj (shkëputur nga TIMS në vitin 2024 me qëllim rritjen e performancës); (xi) kundravajtjet administrative të automjeteve dhe masat plotësuese mbi lejet e drejtimit (shkëputur nga TIMS në vitin 2024 me qëllim rritjen e performancës); (xii) personat në kërkim, dokumenta në kërkim, automjete në kërkim, kombëtar dhe ndërkombëtar etj.; (xiii) informacion për shtetas të huaj të shpallur non grata apo të cilëve ju ndalohet hyrja në Republikën e Shqipërisë.

41. Mbledhja dhe trajtimi i të dhënave dhe të informacioneve të përmendura më lart, ka për qëllim ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, parandalimin dhe hetimin e veprave penale, kontrollin kufitar dhe menaxhimin e migracionit.

42. Sistemi TIMS aksesohet përmes rrjetit të Policisë së Shtetit. Sektori i Menaxhimit të Informacionit mundëson dhënien e aksesit për punonjësit e Policisë në bazë të parimit “nevojë për njohje” sipas detyrave funksionale. Duke qenë një sistem i qendëruar, çdo informacion i hedhur apo përditësuar në sistemin TIMS i shfaqet menjëherë të gjithë përdoruesve të autorizuar për të parë këtë informacion, në çdo post pune në Policinë e Shtetit.

43. Në sistemin TIMS, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara midis Policisë së Shtetit dhe institucioneve të tjera ligjzbatuese, kanë akses për të parë informacionin e tij sipas niveleve të ndryshme të aksesit edhe: (i) përdorues nga prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm në të gjitha rrethet gjyqësore; (ii) përdorues pranë Prokurorisë së Përgjithshme; (iii) përdorues pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar; (iv) përdorues pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit; (v) përdorues pranë Shërbimit Informativ Shtetëror; (vi) përdorues pranë Drejtorisë Rajonale të Doganave; (vii) përdorues pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave; (viii) përdorues pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor; (ix) përdorues pranë përfaqësive diplomatike e konsullore të vendit tonë, kudo në botë.

44. Në dëshminë e dhënë në datën 04.06.2024, ministri i Brendshëm, zoti Taulant Balla ka deklaruar se nga viti 2004 deri më sot, numri i llogarive që kanë pasur akses në sistemin TIMS janë 7 mijë e 452 përdorues, nga të cilët janë aktivë 4 mijë e 417 përdorues, çka në vlerësimin e ministrit përbën një numër shumë të madh dhe rrit mundësinë e ekspozimit.

45. Me qëllim forcimin e kapaciteve dhe përditësimin e sistemit TIMS, në bazë të kërkesave për përmirësime të funksionaliteteve të kërkuara nga strukturat e saj, si dhe detyrimet që rrjedhin për integrimin në Bashkimin Evropian, Policia e Shtetit ka parashikuar një fond prej 160 milionë lekë ose 1.6 milionë euro për vitet 2024 – 2025 për ri-dizenjimin e plotë të këtij sistemi.

B. NDËRHJRJA NË SISTEM

46. Duke ju referuar shkresës **Nr. 2707 Prot, datë 08.08.2023**, të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me lëndë: “Dergim materiali për fillimin e procedimit penal”, rezulton se në datën 02.08.2023, ora 14:51, punonjësi i Policisë, Z. Ardit Muço, ka dërguar një e-mail, nga e-maili i tij i punës, tek adresat sisteme-it@aso.gov.al; dba-it@asp.gov.al, siguria-it@asp.gov.al. Ky e-mail i është bërë CC Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorit

të Departamentit të Policisë Kriminale dhe Drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave. Po në datën 02.08.2023, ora 22:54, në adresat e sipërpërmendura, por edhe në adresën elektronike të Ministrit të Brendshëm dhe Drejtuesit të Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, ka mbërritur një e-mail me subjekt “ndaloni vjedhjen e të dhënave”, dërguar nga adresa denoncuesit@proton.me.

47. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni Hetimor dhe dëshmitë e mara nga personat e thirrur për të dëshmuar përpara Komisionit Hetimor, lidhur me momentin e marrjes së dijenisë mbi ngjarjen nga drejtuesit e institucioneve kryesore të linjës, si Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit dhe Drejtuesi i Agjencisë së Mbikqyrjes Policore, ka rezultuar se:

47.1 Referuar shkresës me Nr. 4546/1, datë 29.04.2024 të Ministrisë së Brendshme, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe dëshmisë së Ministrit të Brendshëm përpara Komisionit Hetimor, del qartë fakti se Ministri i Brendshëm Z. Taulant Balla, është vënë në dijeni për ngjarjen në mbrëmjen e datës 02.08.2023, pas mbërritjes së e-mailit të sipërpërmendur në orën 22:54, në postën e tij elektronike zyrtare. Sapo është njohur me përmbajtjen e e-mail-it, ai ka njoftuar Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorin e Agjencisë së Mbikqyrjes Policore për kryerjen e të gjitha verifikimeve në lidhje me rastin. Për ngjarjen Ministri i Brendshëm ka njoftuar edhe Kryeministrin i cili ka kërkuar ndjekjen e të gjitha procedurave të parashikuara nga kuadri ligjor përkatës.

47.2 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me anë të shkresës Nr. 3755/2 Prot, datë 26.05.2024, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, ka sqaruar se në adresën elektronike zyrtare të Drejtuesit të Policisë së Shtetit muhamet.rumbullaku@asp.gov.al, kanë mbërritur dy mesazhe. Konkretisht e-mail-i i datës 02.08.2023, ora 14:51, me subjekt “Tërheqje vëmendje”, dërguar nga Z. Ardit Muco Shef i Sektorit të Serverave dhe ai i datës 02.08.2023 ora 22:54, me subjekt “Ndaloni vjedhjen e të dhënave të policisë së shtetit, dërguar nga adresa e paidentifikuar denoncuesit@proton.me.

47.3 Në kohën e mbërritjes së e-mail-eve Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit ka qenë në aktivitet në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër. Drejtuesi i Policisë së Shtetit Z. Muhamet Rumbullaku, ka marrë dijeni për ngjarjen kur ka aksesuar aksesuar e-mail-in e tij zyrtar në datë 03.08.2024 rreth orës 08:00. Aksesit në postën elektronike kryhet vetëm nga zyra dhe jo nga celulari drejtuesve të Policisë, për shkak të sigurisë që prej sulmit kibernetik të shtatorit të vitit 2022. Këto rrethana u konfirmuan edhe nga Z. Muhamet Rumbullaku gjatë dhënies së dëshmisë së tij përpara Komisionit Hetimor. Lidhur me njoftimin e marrë nga Ministri i Brendshëm në datë 02.08.2023, ai nuk ka dhënë sqarime dhe ka rikonfirmuar se dijeni për ngjarjen ka marrë në datë 03.08.2023 në mëngjes, pasi nëse do të ishte e kundërta ai do të ishte nisur menjëherë për në ambientet e DTI, për të verifikuar veprimet e vartësve të tij.

47.4 Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Agjensia e Mbikqyrjes Policore, në lidhje me dijeninë për ngjarjen. Me anë të shkresës Nr. 1561 Prot, datë 26.04.2024, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, ky institucion sqaron se në adresën e postës elektronike të Drejtorit të Përgjithshëm të AMP-së, në datë 02.08.2023 ora 10:54, ka ardhur një e-mail nga adresa denoncuesit@proton.me. E-mail është aksesuar nga drejtuesi i institucionit në datë 03.08.2023, që për atë periudhë, ka qenë Z. Ardi Veliu. Në dëshminë e tij përpara Komisionit Hetimor, Z. Ardi Veliu, shprehet se për ngjarjen është vënë në dijeni në datën 03.08.2024, kur ka aksesuar e-mail-in zyrtar të punës në ambientet e punës, pasi kjo adresë elektronike nuk mund të aksesohet nga një pajisje tjetër për arsye të sigurisë.

48. **Konkluzion:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se njoftimi i parë për një ndërhyrje të paligjshme në sistemin TIMS ka ardhur nëpërmjet një email-i në orën 14:51 të datës 02.08.2023 nga shefi i Sektorit të Serverave, zoti Ardit Muço, i cili iu është përcjellë drejtuesve kryesorë të Policisë së Shtetit. Më pas njoftimi i dytë ka ardhur nëpërmjet një email-i në orën 22:54 të datës 02.08.2023, ku krahas drejtuesve të Policisë së Shtetit, janë informuar mediat dhe drejtuesit kryesorë të shtetit, përfshirë Ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e Agjencisë së Mbikqyrjes Policore. Megjithë njoftimet e marra nga Ministri i Brendshëm, zoti Taulant Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zoti Muhamet Rrumbullaku, Drejtori i Agjencisë së Mbikqyrjes Policore në datën 02.08.2023, datë në të cilën ka filluar edhe ndërhyrja në sistemin TIMS, reagimi institucional ka ardhur vetëm ditën e nesërme në datën 03.08.2023. Deklarimet e zotit Balla, zotit Rrumbullaku dhe zoti Veliu sa i përket marrjes dijeni dhe komunikimeve me njëri-tjetrin janë kontradiktore dhe nuk përputhen me njëra-tjetrën. Nëse reagimi do të kishte qenë në kohë, ndërhyrja e filluar në orën 18:00 të datës 02.08.2023 dhe e shtrirë deri në orën 02:00 të datës 03.08.2023, mund të ishte parandaluar.

49. Me autorizimin nr. 939 datë 03.08.2023 të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit është ngritur grupi i punës nga punonjës të Drejtorisë së Standarteve Profesionale dhe Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike, me qëllim verifikimin e ankesës ardhur me anë të e-mail-ve të datës 02.08.2023, mbi mundësinë e vjedhjes së të dhënave të sistemit TIMS. Grupi i punës ka kryer disa veprime verifikuese procedurale, duke marrë deklaratimet e punonjësve të Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit, këqyrjen e kamerave të sigurisë, sistemeve të hyrje-daljeve dhe sekuestrimin e pajisjeve fizike të gjendura në ambientet e DTI, të pasqyruara këto në Raport Vlerësimin “Për zbatimin e procedurave standarte të punës në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit”, me Nr. 939/1-a Prot, datë 04.08.2023, përpiluar nga Drejtoria e Standarteve Profesionale.

50. Nga analizimi të tërësi i deklaratimeve të dhëna nga punonjësit e DTI, del qartë fakti se në datën 02.08.2023, rreth orës 13:00, në ambientet e DTI, është paraqitur Drejtori Ervin Muça, i cili i ka kërkuar vartësve të tij të kryenin një “Back-up të databazës së sistemit TIMS”. Gjithashtu drejtori i DTI, ka kërkuar që të mbylleshin akseset në sistem të Shefit të Sektorit të Serverave Z.

Ardit Muço. Këto urdhëra janë dhënë në mënyrë verbale, duke ju drejtuar punonjësve me tone të larta dhe duke i vënë ata nën kushtet e një presioni të vazhdueshëm për zbatimin e tyre, deri edhe në kërcënime për ndjekje penale për moszbatim urdhëri. Të dhënat e sistemit do të eksportoheshin në një Hard Disk të jashtëm, të cilin e kishte sjellë vetë Ervin Muça. Mbetet e paqartë se nga ishte marrë kjo pajisje. Ky Hard Disk do të ruhej në një kasafortë në rast dëmtimi të sistemit apo sulmi të tij, për ta pasur si rezervë për ruajtjen e të dhënave. Gjatë këtij procesi, në ambientet e DTI-së janë paraqitur edhe dy persona të tjerë që punonjësit nuk i njihnin, por që më pas janë identifikuar si Klodian Mazari dhe Marjana Shehaj, përkatësisht njohje shoqërore e shtetasve Ervin Muça dhe Besjon Tanuzi.

51. Specialistët e Sektorit kanë njoftuar shefin e Sektorit të Serverave në DTI, Z. Ardit Muça, i cili nodhej me leje, për këtë fakt. Ai i ka porositur specialistët e tij të mos kryejnë asnjë veprim pa miratimin e tij dhe pa parqitjen e një kërkesë formale për kryerjen e tyre. Po në datën 02.08.2024, ora 14:34, Z. Ardit Muço është telefonuar nga Drejtori i DTI, Z. Ervin Muça, i cili i ka kërkuar vënien në dispozicion të kodeve të serverave të bazës së të dhënave të sistemit TIMS. Ardit Muço ka refuzuar ta kryejë një veprim të tillë dhe ka dërguar një e-mail vartësve të tij ku u kërkonte të mos kryenin asnjë veprim për eksportimin e bazës së të dhënave të sistemit TIMS, pasi ishte në kundërshtim me ligjin.

52. Këto fakte janë pohuar edhe nga vetë shtetasi Ervin Muça, gjatë dëshmisë dhënë përpara Komisionit Hetimor, ku u thirr në cilësinë e dëshmitarit. Ky i fundit është shprehur se për veprimet e kryera nuk kishte marrë autorizim konkret nga eprorët e tij, pasi në asnjë moment ligji nuk e ndalonte shprehimisht kryerjen e këtyre veprimeve. Edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, gjatë dëshmisë së tij përpara Komisionit Hetimor, e konfirmoi faktin se nuk ka pasur dijeni për këto veprime dhe që në asnjë moment nuk është njoftuar mbi kryerjen e ndonjë procedurë Back-Up të sistemit TIMS, nga drejtuesi i DTI.

53. Në lidhje me personat e paautorizuar për të hyrë në ambientet e Departamentit të IT-së, të Policisë së Shtetit, gjatë dëshmisë së tij përpara Komisionit Hetimor, zoti Ervin Muça ka deklaruar se shtetasi Klodian Mazari ka qënë njohje personale e tij dhe se e ka patur vartës kur ka qënë i punësuar pranë AKSHI-it. Atë ditë e ka shoqëruar në ambientet e DTI, për të ndihmuar në kryerjen procesit të “Back-Up”, pasi nga punonjësit e DTI nuk po mundësohej kryerja e këtij procesi. Ndërsa për sa i përket shtetasës Marjana Shehaj, Drejtori i Sistemeve pranë DTI Z. Besjon Tanuzi, deklaroi në dëshminë e tij se ajo ishte një njohje personale e tij dhe se ndodhej rastësisht në ambientet e DTI, për ta uruar për marrjen e detyrës së re.

54. Nisur nga hetimet dhe verifikimet e kryera në tërësi nga grupi i punës, i ngritur me autorizimin e sipërcituar të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ka rezultuar se:

- Nga verifikimi i dy IP-ve dërguese të e-mail-eve që janë dërguar tek titullarët e Policisë së Shtetit dhe tek persona të tjerë jashtë Policisë, njëra IP dërguese rezulton brenda territorit të RSH dhe tjetra jashtë territorit të RSH.
- Lidhur me ngjarjen është bërë verifikimi i pamjeve filmike, verifikimi i hyrje daljeve në institucion dhe verifikimi i IP-ve që janë përdorur për t'u loguar dhe lidhur me sistemet TIMS.
- Janë administruar printimet e hyrje-daljeve në institucion dhe në dhomën e serverave.
- Nga verifikimi i pamjeve filmike ka rezultuar se më datë 02.08.2023, në orën 17:45:33, tek porta kryesore kanë hyrë Besjon Tanuzi, së bashku me një shtetas të identifikuar si Klodian Mazari, me detyrë përgjegjës sektori në AKSHI, pranë QKB dhe një vajzë e identifikuar me emrin Marjana Shehi, e cila nuk është punonjëse e DTI. Këta dy persona të shoqëruar nga Besjon Tanuzi kanë hyrë në derën kryesore të godinës dhe më pas ngjiten lart në katin e dytë (hyrja tek porta kryesore është bërë duke futur kodin e Ljubica Dervishit nga ana e Besjon Tanuzi).
- Më pas në orën 17:46:33, zbresin nga kati i dytë dhe futen tek zyra e BCC punonjësit: Ervin Muça, Klodian Mazari, Xhulia Çollaku, Albana Vrapit, Elvis Hysi dhe Enkli Hoxha.
- Gjatë kësaj kohe në zyrën BCC ka qëndruar gjatë gjithë kohës shtetasi Klodian Mazari dhe disa punonjës të DTI.
- Më pas, në orën 23:52:33 kanë dalë nga zyra e BCC shtetasi Klodian Mazari dhe Albana Vrapit. Zyra mbyllet nga kjo e fundit dhe të dy ngjiten në katin e dytë.
- Në orën 23:54:08 ka dalë nga zyrat e DTI punonjësja Albana Vrapit dhe më pas, në orën 00:19:03 të datës 03.08.2023, kanë zbritur nga kati i dytë dhe dalin jashtë drejtori i DTI Ervin Muça dhe Klodian Mazari;
- Nga kqyrja e pamjeve filmike të korridorit kryesor të institucionit të DTI, rezulton se drejtori i DTI Ervin Muça dhe Drejtori i Drejtorisë së Sistemeve në DTI Besjon Tanuzi, kanë hyrë dhe kanë dalë disa herë nga ky institucion në periudha të ndryshme kohore.
- Nga verifikimi ka rezultuar se në orën 23:01, ka dalë nga institucioni drejtori i DTI Ervin Muça dhe në sistemin e hyrje-daljeve rezulton se ka përdorur kodin e punës të punonjësës Ljubica Dervishaj. Në orën 23:16 Ervin Muça hyn përsëri në institucion duke përdorur kodin e hyrjes së Ljubica Dervishaj (gjatë deklarimeve kjo e fundit ka thënë se kodin ja kishte dhënë vetëm Drejtorit Besjon Tanuzi).
- Është gjetur dhe hard disk që do të përdorej për ruajtjen e të dhënave sipas dëshmisë së punonjësës Xhuljeta Çollaku.
- Nga kqyrja e të dhënave të serverit të bazës së të dhënave të sistemit TIMS, në **user-in "oracle"**, rezultoi se në dosjet me emërtime **"fullBackup"**, **"fullBackup2"** dhe **"fullBackup3"**, ndryshimi i fundit ishte bërë më datë 03.08.2023, ora 01:39:34. Gjithashtu brenda dosjes me emërtimin **"fullBackup3"** ndodheshin tre skedarë për të cilët ndryshimi i fundit ishte bërë në datë 02.08.2023, ora 23:53. Brenda dosjes me emërtimin **"fullBackup2"**, ndodheshin katër skedarë ku për tre prej tyre ndryshimi i

fundit ishte bërë në datë 02.08.2023 ora 21:27, ndërsa për skedarin tjetër ndryshimi ishte bërë në datë 02.08.2023, ora 23:20. Në dosjen me emërtimin “fullBackup” ndodheshin dymbëdhjetë skedarë ku për nëntë prej tyre ndryshimi i fundit ishte bërë në datë 03.08.2023, ora 00:31, ndërsa për tre skedarët e tjerë ndryshimi i fundit ishte bërë në datë 03.08.2023 ora 00:30.

- Gjatë intervistimit, Drejtori i Departamentit të DTI-së Ervin Muca, ka sqaruar se nuk ka të administruara rregullore apo procedura standarte, për funksionimin e DTI-së, dhe se nuk ka ndonjë urdhër apo material shkresor në lidhje me veprimet në fjalë. Nga verifikimet e kryera rezulton se janë administruar në librarinë elektronike, në faqen zyrtare të policisë së shtetit, procedura standarte dhe përshkrime të punës për DTI-në. Gjithashtu referuar Programit të Punës nr. 3410, datë 28.04.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, “Për rishikimin e procedurave standarte të punës”, për të gjitha strukturat, nuk ka pasur dërgim material nga ana e DTI, në lidhje me këtë detyrim që lidhet me afatin 30.07.2023, pavarësisht komunikimeve apo kërkesave në rrugë elektronike me Sektorin e Koordinimit të Politikave dhe Procedurave Standarte.

55. Pas vlerësimit dhe analizimit të të gjitha fakteve dhe provave të administruara, në Raport Vlerësimin “Për zbatimin e procedurave standarte të punës në Departamentin e Teknologjisë së Informacionit”, përpiluar nga Drejtoria e Standarteve Profesionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, konstatohet se nga Drejtuesi i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Z. Ervin Muca dhe punonjësit në vartësi, janë kryer disa shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, si vijon:

- 1- Referuar ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”, në nenin 4 të tij “Krijimi i bazës së të dhënave shtetërore”, pika 3, “ndalohet krijimi i bazave të të dhënave shtetërore të vecanta për të njëjtin informacion ose qëllim” dhe nuk trajton transmetimin e bazës së të dhënave në databaza të tjera apo pajisje të tjera të ngjashme.
- 2- Drejtori i DTI ka **shkelur** parashikimet ligjore të VKM-së Nr. 710 datë 21.08.2013 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, pika 1 shkroja c e cila parashikon se: *“Institucioni duhet të hartojë dokumentin e politikave të vazhdueshmërisë së punës dhe një plan për ruajtjen e informacionit, në përputhje me udhëzimet të nxjerra nga ministri për çështjet e teknologjisë së informacionit.”*
- 3- Referuar Procedurave Standarte “Për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve nga punonjësit e policisë së shtetit” miratuar me **Urdhër Nr. 429, datë 26.04.2017** të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, konkretisht shkronja **B** pika 1/b *“Sigurimi I jashtëm I objekteve synon në kontrollin e zbatimit e rregullave të regjimit të hyrje dakjeve së punonjësve të këtyre objekteve të personave të tjerë”*, shkronja **C**, pika 5/d, *“në rastet e konstatimit apo të prishjes së sigurisë në ndonjë ambient apo në zyrë, personi i cili ka bërë konstatimin njofton menjëherë shërbimin e drejtimit, I cili vë në dijeni titullarin e institucionit. Gjatë kësaj kohe ambienti ruhet derisa të mbërrijnë personat përgjegjës për*

menaxhimin e kësaj situate”, shkronja F, pika 2, “Hyrja ose dalja e punjosëve në ambientet e punës jashtë orarit zyrtar dhe/ose në ditë pushimi, evidentohet nga punonjësit e shërbimit të ruajtjes”, shkronja F, pika 5, “Punonjësit e strukturave të varësisë që kërkojnë të hijnë për nevoja pune në institucione, do të lejohen pas konfirmimit nga struktura përkatëse dhe pajisjen me fletë hyrje-dalje ditore. Për rastet e parashikuara në këtë pikë, punonjësit e shërbimit bëjnë evidentimin e hyrje dakjeve në ndërtesa/mjediset e institucionit”, evidentohet moszbatimi i rregullave të sipërpërmendura të hyrjeve dhe të daljeve nga institucioni, s inga drejtuesit dhe punonjësit e institucionit, ashtu edhe nga punonjësit e shërbimit të ruajtjes së institucionit.

- 4- Titullari i institucionit, referuar nenit 35, 36, 37 të ligjit Nr. 10/2023 “Për informacionin e klasifikuar”, duhet të kishte miratuar me urdhër ndarjen e Zonave të Sigurisë, planin dhe skemën e ruajtjes së sigurisë fizike të objektit ku mbahet dhe ruhet informacion i klasifikuar. Me urdhër të titullarit duhet të përcaktohen Zonat Teknikisht të Sigurta. Gjithashtu duhet të ishte përcaktuar “Mënyra e ruajtjes fizike”. Këtu përfshihen tërësia e masave teknike dhe elektronike për të bërë të mundur shmangien e hyrjes me forcë ose të fshehtë të personave dhe mjeteve të paautorizuara, dhe vendosja e pajisjeve, mjeteve dhe sistemeve të vëzhgimit, sinjalizimit e kontrollit me qëllim parandalimin e hyrjes së personave të paautorizuar në zonat e sigurisë.
- 5- Drejtori i Departamentit të DTI, Ervin Muca dhe Drejtori i Sistemeve në këtë departament Besjon Tanuzi, **nuk janë pajisur me CSP** dhe as nuk kanë aplikuar.
- 6- Ervin Muca dhe Besjon Tanuzi kanë lejuar hyrjen në institucion të personave të paautorizuar.
- 7- Kanë urdhëruar punonjësit e vartësisë, për të kryer veprime në kundërshtim me detyrën që ata ushtrojnë.
- 8- Në lidhje me veprimin që kanë ndërmarrë me gjithë stafin e tij, Ervin Muca, nuk ka informuar pranë DPPSH, nëpërmjet një memo informuese, informacioni apo një plan veprimi për problematikat e konstatuara dhe veprimet e ndërmarra nga ana e tij për rregullimin e tyre.
- 9- Fakti që veprimet janë kryer në orët e vona të natës, janë futur persona të paautorizuar jo pjesë e stafit, është check-uar me pinin personal të një punonjësi tjetër joprezent, krijon dyshime të arsyeshme për veprime jo korrekte dhe në kundërshtim me ligjin.

56. Në analizë të veprimeve të mësipërme, dyshohet se në sistemet përkatëse ka patur ndryshime dhe pikërisht në skedarët e “back-up”, të cilat për t’u përcaktuar saktësisht kërkojnë ekspertim kompjuterik nga ekspertë të fushës. Nga ana e Strukturës së Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me kërkesë të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tirnanë, është kryer akt ekspertimi i provave digjitale, për efekt të hetimeve që po kryhen për ngjarjen, fakt për të cilin jemi vënë në dijeni nga ana e SPAK me anë të shkresës nr. 6123/1, datë 25.04.2024, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë. Akti i ekspertimit nuk na është vënë në dispozicion.

57. Lidhur me ngjarjen dhe për kryerjen e veprimeve të nevojshme proceduriale, është ngritur një grup pune edhe nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, me qëllimin për verifikimin e problematikës së ngritur në e-mail-et e dërguara në adresat e drejtuesve të policisë dhe personave të tjerë. Në vijim të veprimeve proceduriale është kryer një inspektim të Departamentin e Teknologjisë së Informacionit. Në përfundim të këtyre hetimeve, referuar shkresës Nr. 2014/1 Prot, datë 07.08.2023, përpiluar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, ka rezultuar se nga ana e Drejtorit të DTI dhe vartësve të tij, janë kryer disa shkelje të ligjit, që vijnë si më poshtë:

- a) Drejtori i Departamentit të TI dhe Drejtori i Drejtorisë së Serverave në DTI, pavarësisht se janë funksione të cilat njihen dhe administrojnë informacion të klasifikuar, janë të papajisur me Certifikatë të Sigurisë së Personelit.
- b) Drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit ka urdhëruar kryerjen e procesit, të back up, pa një urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, në kundërshtim me procedurën standarde të punës dhe në mungesë të një urdhëri ose dokumenti tjetër që e legjitimon këtë gjë.
- c) Urdhri i Drejtorit të Departamentit të DTI për hapjen e portës USB bie ndesh me Telegramin nr. 4326, datë 15.05.2023 i DPPSH, "Mbi mënyrën e përdorimit dhe administrimit të sistemeve dhe pajisjeve teknologjike në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit".
- d) Hyrja e shtetasve të paautorizuar në ambjentet e laboratorit të DTI, i cili është ambient i sigurisë së lartë duke kryer edhe veprime të drejtpërdrejta në sistemet në administrim të Policisë së Shtetit është në kundërshtim me "Procedurat standarde të punës për rregullat e hyrje/daljeve të personave në mjediset e Policisë së Shtetit", miratuar me urdhër nr. 508/1, dt. 17.6.2022 të DPPSH.

58. Lidhur me hetimet e kryera për rastin dhe konstatimet e bëra gjatë tyre, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit janë marrë disa masa disiplinore të përkohshme. Me Vendimin Nr. 409, datë 03.08.2023, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ka pezulluar nga detyra për një periudhë 5-ditore Drejtorin e Departamentit të Teknologjisë së Informacionit Z. Ervin Muça dhe është filluar hetimi disiplinor për Drejtuesin e Lartë Ervin Muça, i cili do të kryhej nga Komisioni Qendror i Apelit. Rezultatin e këtij hetimi nuk e kemi, por nga rrethanat del qartë fakti se Ervin Muça ka vazhduar ta mbajë postin e Drejtuesit të DTI, pasi gjatë kësaj kohe i ka propozuar për emërim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtorin e Drejtorisë së Sistemeve në DTI-në e Policisë së Shtetit, Z. Enri Ndoni.

59. Gjatë kësaj kohe ka nisur hetimi disiplinor për Drejtorin e Sistemeve në DTI, Z. Besjon Tanuzi. Rezultatin e këtij hetimi nuk e disponojmë, por nga vlerësimi i provave dhe fakteve rezulton se ndaj këtij punonjësi, nuk është marrë asnjë masë pezullimi nga detyra në momentin e parë. Ai është dorëhequr nga detyra pas ngjarjes së ndodhur në datat 2 – 3 Gusht 2023. Me vendimin Nr. 408, datë 03.08.2023, Shefi i Sektorit të Serverave, Ardit Muça, është pezulluar nga

detyra. Është urdhëruar që për punonjës in administrativ Ardit Muco të fillojë hetimi administrativ për shkelje të rëndë, me arsyetimin se ka dy javë që nuk është paraqitur në detyrë. Ndërkohë që ky shtetas ka qënë me leje dhe është kthyer në punë normalisht pas përfundimit të periudhës së lejes. Pra, për punonjës in që ka denoncuar ngjarjen dhe që ka njoftuar vartësit për mos të zbatuar urdhëra të dyshuar si të kundraligjshëm, është vendosur masë pezullimi nga detyra, ndërsa për punonjës in që ka marrë pjesë në veprime të dyshuara si të kundraligjshme, është lejuar vijimi normal i detyrës.

60. Për punonjës it e tjerë, pavarësisht se kanë marrë urdhër nga Drejtori DTI, përkatësisht specialistët Albana Vrapit, Xhuljana Collaku, Enkli Hoxha, Elvis Hysi, Egis Hidri, Ljubica Dervishaj dhe Griselda Sina, ka nisur hetimi administrativ për shkelje të rëndë disiplinore. Rezultatet e këtij procedimi disiplinor nuk na janë vënë në dispozicion. I pyetur gjatë dëshmisë së tij në Komisionin Hetimor mbi mosfillimin e procedurave për largimin nga strukturat drejtuese të Policisë së Shtetit të zotit Ervin Muça dhe personave të tjerë, që rezultojnë të përfshirë në këtë ngjarje, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit u justifikua me faktin se janë në pritje të vendimit gjyqësor penal të formës së prerë. Megjithatë, siç u evidentua nga ana e deputetëve të Komisionit Hetimor, ky nuk ka qënë standardi i ndjekur nga Policia e Shtetit, në rastet e tjera, kur pavarësisht se nuk ka pasur vendim penal të formës së prerë, është marrë vendimi për përjashtimi nga strukturat e Policisë.

61. Në datën 08.08.2023, me shkresën Nr. 2707 Prot., të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, i është përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, "Informacioni për referimin e veprës penale". Me anë të shkresës me nr. 11097 Prot, datë 09.05.2024, drejtuar Kuvendit të Shqipërisë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka informuar se në bazë të materialit referues të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, është regjistruar me Nr. Kallzimi 9866, datë 01.09.2023. Materiali i përcjellë për vlerësim nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, i është bashkuar materialit procedural me Nr. Kallzimi 9866, datë 01.09.2023.

62. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka regjistruar procedimin penal Nr. 5404, datë 01.09.2023 për veprat penale "Shpërdorimi i detyrës" dhe "Hyrja e paautorizuar kompjuterike", parashikuar nga nenet 248 dhe 192/b të Kodit Penal. Mbështetur në rrethanat e faktit si dhe tërësinë e akteve të procedimit penal Nr. 5404, datë 01.09.2023, nga ana e organit të akuzës është kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në shtëpi" dhe "Pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik" për shtetasin Ervin Muça. Kjo kërkesë është miratuar nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Tiranë me anë të vendimit Nr. 919 Regj, datë 09.04.2024.

63. Në datë 31.08.2023 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ka nxjerrë urdhrin Nr. 1237 "Për miratimin e manualit për sigurinë e informacionit" dhe urdhrin Nr. 1238 "Për miratimin e manualit për vazhdueshmërinë e punës në rastet e ndodhjes së një incidenti, ndërprerje të shërbimeve apo fatkeqësie". Këto urdhra janë nxjerrë pas ndërhyrjes në sistemin TIMS ndërkohë

që ka qënë detyrë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Drejtuesit të DTI, të merrnin masa për zbatimin e Urdhrit Nr. 47, datë 14.04.2023 të Ministrit të Brëndshëm “Për miratimin e structures së Policisë së Shtetit” dhe të Programit të Punës të miratuar nga vetë DPPSH, me Nr. 3410, datë 28.04.2023 “Për rishikimin e Procedurave Standarte të Punës për të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit”.

64. **Konkluzioni:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se shtetasi Ervin Muça, me detyrë Drejtor i Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit, së bashku me Drejtorin e Drejtorisë së Sistemeve, Besjon Tanuzaj, dhe punonjës të tjerë të Departamentit të IT-së, kanë kryer një sërë shkeljesh ligjore, duke vënë në rrezik sigurinë e sistemit të dhënave TIMS. Konkretisht, këta shtetas në bashkëpunim me njëritjetrin kanë lejuar hyrjen e paautorizuar në ambientet e rëndësisë së veçantë të Policisë së Shtetit, nuk kanë marrë leje apo autorizim paraprak nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për kryerjen e procesit të back-up-it, kanë bërë transferimin pjesërisht të të dhënave të sistemit TIMS në pajisje të jashtme, kanë hyrë në godinë duke përdorur kodin e një punonjëse që ishte me leje vjetore, kanë operuar në orët e vona të natës dhe jashtë orarit zyrtar, kanë urdhëruar vartësit për kryerjen e detyrave në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk kanë hartuar aktet sipas Urdhërit Nr. 3410, datë 28.04.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Megjithë shkeljet flagrante të ligjit, këta punonjës janë pezulluar vetëm për një periudhë 5-ditore dhe më pas janë lejuar që të vijojnë punën normalisht, pa filluar procedura e shkarkimit nga detyra, në kushtet kur qoftë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ashtu edhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore kishin konstatuar kryerjen e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, dhe duke vënë në rrezik sigurinë e një infrastrukture kritike për Policinë e Shtetit.

III. HAKERIMI I SISTEMIT TIMS

65. Gjatë dëshmisë së tij të datës 04.06.2024, Drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, zoti Ervin Muça deklaroi se ndaj sistemit TIMS kishte pasur dy sulme kibernetike, i pari i ndodhur në 14 tetor 2021 dhe i dyti i ndodhur në 9 shtator 2022. Sulmi i parë ishte mbajtur i fshehtë, pa u kryer ndonjë hetim apo marrë ndonjë masë konkrete, çka ishte bërë shkak që më pas të ndodhte edhe sulmi i dytë i hakerave iranianë. Si rezultati këtyre sulmeve, zoti Muça deklaroi se të dhënat e sistemit TIMS deri në shtator 2022, gjenden në kanalin online. Pra, ato janë lehtësisht të aksesueshme nga kushdo, që ka interes, duke përfshirë këtu edhe grupet e krimit të organizuar.

66. Gjithashtu ai deklaroi se ka pasur edhe raste të tjera kur sistemet e Policisë së Shtetit janë prekur nga sulme Kibernetike, për të cilat duhej të ishte bërë një hetim i plotë, por që në cdo rast që ka pasur një problematikë të tillë, justifikimi kryesor ishte se e kanë bërë “Iranianët”. Kjo gjë nuk ishte e vërtetë, pasi hetimet nuk u thelluan në mënyrë që të zbulohesh në të vërtetë kush ishin autorët e sulmeve në sistemet e Policisë së Shtetit.

67. Kjo gjë vërtetohet edhe nga Memo nr. 2303 Prot, datë 08.10.2021, ku ish-drejtuësja e Drejtorisë së IT-së, Nevila Xoxa, konfirmon se në atë datë në orën 14:20, disa kompjutera të disa përdoruesve administrativë, pikërisht në sektorin e databazës, kanë ekzekutuar skedarë “malëare”, e thënë ndryshe kanë pësuar sulm kibernetik. Drejtuesit dhe punonjësit e Drejtorisë së IT-së dhe sektorit të krimit kibernetik, me veprimet dhe mosveprimete e tyre, nuk kanë bërë një analizë të situatës, për të evidentuar mënyrën e ndërhyrjes, nga vinte ndërhyrja dhe çfarë pasojash kishte dhe nëse mund të merreshin masa për neutralizimin dhe rikuperimin e të dhënave. Në fakt kjo ngjarje u fsheh, dhe pasojat u bënë evidente kur të dhënat u ekspozuan në shtator të vitit 2022, në kanale online.

68. Gjatë deklarimeve të tij, Ervin Muça, shprehu se këto sulme, u kryen edhe në sistemet e Policisë “Ransomëare”, të cilët arritën të preknin cdo *endpoint*, ose pikë fundore, përdoruesit fundorë, sepse personat që e kanë pasur për detyrë nuk bënë asnjë izolim të infrastrukturës, kur u identifikua sulmi i tetorit të vitit 2022. Ky sulm mund të evidentohet nëse do të kishte një hetim dhe analizë të plotë të sulmit të vitit 2021, që ishte një indicie për evitimin e katastrofës së vitit 2022. Konstatimet e tij, zoti Muça i mbështeti edhe në hetimet e kryera nga agjencitë ligjzbatuese amerikane dhe ekipi DART i Microsoft, sipas të cilëve

nuk u bë i mundur kthimi plotësisht i të gjitha të dhënave të sistemeve elektronike.

69. Zoti Muça solli në vëmendje faktin se edhe pse policia dispononte zyrtarisht të gjithë indikatorët e sulmit të korrikut të vitit 2022 të institucioneve publike shqiptare, punonjësit e Drejtorisë së TI, nuk kryen asnjë skanim të mjedisit të tyre, për prezencën e këtyre indikatorëve, edhe pse ishin në dijeni të faktit që ishin sulmuar që në vitin 2021. Kjo të çon në konkluzionin se ky fakt ishte fshehur në mënyrë të qëllimshme. Ky mosveprim, solli si pasojë fshirjen e çdo sistemi dhe çdo back-up-i, në sulmin e shtatorit të vitit 2022, duke çuar për javë të tëra në rrëzimin e të gjitha sistemeve.

70. Në përfundim, rikuperimi i sistemeve dhe të dhënave u arrit vetëm falë skuadrës së “*Microsoft-it*”. Nëse stafi i drejtuar nga ish-drejtuësja e Drejtorisë së IT-së, zonja Xoxa, do të kishte kryer detyrën dhe do të skanonte mjedisin për “*indicators of compromise*” (IOC), ose indikatorët e kompromentimit të korrikut 2022, do të ishte stopuar fshirja masive e të dhënave të sulmit të shtatorit të vitit 2022, në sistemet e Policisë së Shtetit, dhe këto janë fakte të pakontestueshme – shpreh zoti Muça.

71. Ekzistenca e sulmeve kibernetike në vitet 2021 – 2022 është konfirmuar edhe nga zoti Endri Ndoni. Konkretisht, gjatë dëshmisë së tij të datës 26.06.2024, Drejtori i Sistemeve në Departamentin e IT-së, zoti Endri Ndoni ka deklaruar se: “Në vitin 2021, unë kisha rreth 6 muaj që isha shkëputur totalisht nga Policia e Shtetit dhe merresha ekskluzivisht me SPAK-un dhe BKH-në. Sidoqoftë, në qoftë se nuk gaboj, por është edhe te memoja, diku rreth datës 10 tetor, e quajmë diku nga tetori, është memoja, ka pasur një sulm kibernetik ndaj rrjetit të Policisë së Shtetit, ku u arrit të enkriptoheshin disa kompjutera që i përdorte IT-ja e Policisë së Shtetit, të gjithë ata persona që rrinin në katin e katërt dhe merreshin me administrimin e sistemeve, jo vetëm sistemi TIMS, por të gjitha sistemeve. Unë nuk di ta them dhe ky është opinion, por unë besoj se Policia e Shtetit është hakëruar që në tetor të 2021-t dhe njerëzit kanë ndenjur aty brenda, kanë marrë informacion, sepse, po ta shikoni, i gjithë informacioni i sistemeve që ka dalë me email-e të ish-drejtorit të Përgjithshëm, Gledis Nano, e me informacione, me hyrje-dalje njerëzish, ky nuk është një informacion, të cilit ti mund ta marrësh sot për sot, sepse flasim për terrabite informacion.”.

72. I pyetur specifikisht nëse sistemi i TIMS është hakëruar, zoti Ndoni është përgjigjur: “A është hakëruar? Po, është hakëruar, sepse ty të doli, sikur hiç fare, informacioni i fluturimeve të kryeministrit tënd në faqen e Telegramit; ty të dolën e-mail-et e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë në çastin kur ai ishte drejtor i Antiterrorit, që është edhe më problematike. Sepse, normalisht, drejtori i Përgjithshëm i Policisë mund të njihet me disa informacione, por ai i antiterrorist të gjithë informacionin e ka të tmerrshëm, sepse flitet për emra, grupe, njëra, tjetra. Kështu që, a është hakëruar? Po, është hakëruar.”.

73. Po ashtu, gjatë dëshmisë së saj të datës 02.07.2024, drejtoresha e Shërbimit Informativ Shtetëror, zonja Vlora Hyseni e pyetur lidhur me hakërimin e të dhënave të sistemit TIMS, ka deklaruar se: “Duhet t’i ndajmë momentet, sulmet kibernetike nga Irani ndaj infrastrukturës elektronike kritike dhe dyshimet për kopjim të paautorizuar të qëllimshme të të dhënave të sistemit TIMS, në rastin konkret gjykojmë se në dark ëeb janë të dhëna të eksfiltruara nga aktorët kibernetikë, gjatë sulmeve kibernetike ndaj infrastrukturës elektronike shtetërore. Të dhënat janë të analizuara, të ndryshuara, të ndërlydhura nga të dhënat e marra nga sistemet dhe janë hedhur qëllimisht në dark ëeb, nëpërmjet llogarisë “Homeland Justice” dhe në momente të caktuara do të vijojnë t’i përdorin për publikime.”.

74. **Konkluzion:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor rezultoi se në datën 14 tetor 2021, ka pasur një sulm kibernetik në sistemet informatike të Policisë së Shtetit, përfshirë edhe sistemin TIMS. Ky sulm nuk është raportuar, nuk janë kryer verifikime apo hetime të thelluara, si dhe nuk janë marrë masa për pastrimin e sistemeve nga viruse të mundshme apo forcimin e masave të sigurisë për rreziqe që mund t’i kanoseshin sistemit nga sulme kibernetike. Po ashtu, rezultoi se në datën 9 shtator 2022 ka pasur një sulm të dytë të sistemeve informatike të Policisë së Shtetit, përfshirë sistemin TIMS, i cili sipas dëshmive ishte pasojë e drejtpërdrejtë e mosmarrjes së masave në rastin e sulmit kibernetik të tetorit 2021. Si rezultat i këtyre dy sulmeve, drejtuesit e Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit kanë deklaruar se të dhënat e sistemit TIMS deri në shtatorin e vitit 2022 gjendet në kanale online dhe mund të blihen nga çdo person që mund të jetë i interesuar. Lidhur me këto pretendime, të cilat mbështeten edhe në dokumentacion zyrtar nuk rezultojnë që të ketë pasur hetime të thelluara administrative apo penale nga institucionet ligjzbatuese. Moskryerja e këtyre hetimeve dhe marrja e masave të nevojshme rrit rrezikun për përsëritjen e sulmeve kibernetike me pasoja shkatërruese për sistemet kritike të Policisë së Shtetit në të ardhmen.

IV. AKSESI I PAAUTORIZUAR NË SISTEMIN TIMS

75. Në përmbajtje të shkresës nr. 3755/2 prot., datë 26.04.2024, Drejtorit i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zotit Muhamet Rrumbullaku ka shpjeguar procedurën se si bëhet dhënia e aksesit për një funksionar të caktuar në sistemin TIMS dhe rregullat e përdorimit të këtij sistemi. Konkretisht, në shkresën e zotit Rrumbullaku thuhet se: “Procedura standarde e punës “Për dhënie e të drejtës dhe mënyrës së përdorimit të llogarive në sistemet e teknologjisë së informacionit në Policinë e Shtetit”, është miratuar me Urdhër nr. 143, datë 04.02.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Kjo procedurë standarde pune ka për qëllim përcaktimin e rregullave, që duhen zbatuar nga punonjësit e strukturave të Policisë së Shtetit, gjatë përdorimit të llogarive në Sistemet e Teknologjisë së Informacionit.”.

76. Më pas, në përmbajtje të shkresës së Drejtorit Rrumbullaku shpjegohet se:
- Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, është struktura përgjegjëse e cila pasi bën verifikimin e punonjësit, përcakton të drejtat duke krijuar një profil, sipas detyrës funksionale të tij dhe vazhdon me procedurat e mëtejshme, për krijimin e përdoruesve (user) në këtë sistem.
 - Sistemet e Teknologjisë së Informacionit monitorohen nga DTI, për mënyrën e menaxhimit të informacionit dhe aksesin e paaautorizuar. Gjatë monitorimit, informacioni mund të shqyrtohet, regjistrohet, kopjohet dhe përdoret vetëm për qëllime të autorizuara hetimi. Ndalohet dhënia e informacionit një pale të tretë pa paaautorizim.
 - Drejtoria e Menaxhimit të Informacionit dhe Mbrojtjes së të Dhënave, në koordinim me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, në mënyrë periodike, duhet të rishikojë të gjithë përdoruesit dhe nivelin e qasjes së tyre, në përputhje me pozicionin aktual të punës.
 - Departamenti për Teknologjinë e Informacionit ka përgjegjësi të plotë, për të gjitha çështjet lidhur me kompjuterët zyrtarë. Asnjë ndryshim, plotësim apo instalim të çfarëdo lloji qofshin, nuk mund të bëhen në kompjuterët zyrtarë pa autorizimin e këtij departamenti.
 - Hyrja në bankën e të dhënave, përdorimi, printimi dhe nxjerrja e të dhënave të Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, jashtë organizatës në kundërshtim me këtë procedurë standarde dhe aktet normative në fuqi, ndëshkohet me masë (administrative) të rëndë disiplinore ose sipas rastit ndiqet penalisht.

77. Në përmbajtje të shkresës nr. 2014/1 prot., datë 07.08.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, zotit Ardi Veliu, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zoti Muhamet Rrumbullaku, citohet përmbajtja e një email-i të dërguar nga Shefi i Sektorit të Sistemeve dhe BCC në DTI, Ardit Muço, në datën 02.08.2023, ora 14:51, në të cilin thuhet se: “Më lejoni t’ju kujtoj gjithashtu se çdo lejim i aksesit në databazat e Policisë nga persona të paautorizuar, që nuk përfaqësojnë Policinë e Shtetit apo një marrëdhënie që rregullohet sipas kontratave apo ligjeve në fuqi, është e ndaluar dhe në kundërshtim me parimet, rregulloren dhe bazën ligjore për administrimin e të dhënave. Çdo eksportim që kryhet deri ditën time të fundit në detyrë, pa autorizim tim në formë të shkruar, është shkelje dhe ngarkon me përgjegjësi personat e përfshirë.”.

78. Megjithëse, parashikimet ligjore rezultojnë shumë të qarta sa i përket mënyrës se si një person mund t’i jepet e drejta e aksesit dhe rregullat e përdorimit të sistemit TIMS, në fakt gjatë hetimit parlamentar ka rezultuar se persona të paautorizuar, të cilët nuk ushtrojnë funksione në Policinë e Shtetit, kanë pasur akses në sistemin TIMS. Lidhur me këtë çështje, gjatë dëshmisë së ministrit të Brendshëm, zotit Taulant Balla, në datën 04.06.2024, kryetari i Komisionit Hetimor e pyeti nëse kishte dijeni që të paktën pesë persona të paautorizuar, sipas një shkrese të vetë strukturave të Policisë së Shtetit, kanë pasur akses të paautorizuar, si dhe mundësinë që dokumentet e tyre, pavarësisht se skanoheshin në sistem, nuk regjistroheshin si të tilla në sistemin TIMS.

79. Lidhur me këtë pyetje, ministri Balla ka dëshmuar se: “Po është e vërtetë që më kanë vënë në dijeni dhe kjo është pjesë e nevojës për ta rregulluar tërësisht, jo vetëm listën e institucioneve që kanë edhe një herë akses, por për të rregulluar në mënyrë definitive dhe për të zvogëluar maksimalisht numrin e user-ave aktivë, duke ruajtur historikun e user-ave për efekt të çdo lloji hetimi të ngjashëm apo hetime të tjera që lidhen me këtë sistem.”. Për të njëjtën problematikë, u pyetën edhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zoti Muhamet Rrumbullaku, drejtori i Departamentit të IT-së, zoti Ervin Muça, drejtori i Drejtorisë së Sistemeve në Departamentin e IT-së, zoti Enri Ndoni dhe paraardhësi i tij në detyrë zoti Besjon Tanuzi. Të gjithë konfirmuan ekzistencën e kësaj problematike dhe nevojën për marrjen e masave për parandalimin e saj në të ardhmen.

80. **Konkluzion:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se persona të caktuar kanë pasur akses të paautorizuar në sistemin TIMS. Megjithëse, ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë në mënyrë të detajuar se si një personi i jepet akses në sistemin TIMS, mbetet e paqartë se si persona privatë, pra që nuk ushtrojnë një detyrë shtetërore që lidhet me aksesimin dhe përdorimin e sistemit TIMS, iu është akses në këtë bazë të dhënash me rëndësi të veçantë. Jo vetëm mënyra, por edhe personat që iu kanë dhënë këtë akses, qëllimet dhe motivet e këtyre personave privatë që kanë pasur akses në sistemin TIMS mbeten të paqarta dhe ngrejnë dyshime serioze për paligjshmëri. Sistemi TIMS përmban një

shumëllojshmëri të dhënash, ashtu siç e kemi shpjeguar më lart, dhe aksesit i lirë nga persona të paautorizuar përbën një rrezik serioz për rendin dhe sigurinë në vendin tonë. Kjo situatë, për të cilën qoftë Ministri, ashtu edhe drejtuesit më të lartë të Policisë së Shtetit duken se ishin në dijeni, duhet të kishte nxitur këta të fundit për marrjen e masave urgjente për kryerjen e një hetimi të thelluar të hyrjeve të paautorizuar në sistemin TIMS dhe marrjen e masave që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

IV. VËNIA NË DISPOZICION E TË DHËNAVE TË TIMS GRUPEVE KRIMINALE

81. Nga hetimet e kryera nga agjencitë ligjzbatuese dhe veçanërisht Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, është konstatuar se punonjës të Policisë së Shtetit apo strukturave të tjera ligjzbatuese, që e kanë për detyrë funksionale ruajtjen dhe administrimin e të dhënave të sistemit TIMS, i kanë vënë në dispozicion të grupeve kriminale përkundërt përfitimeve monetare. Këto grupe kriminale i kanë përdorur këto të dhëna për t'u informuar lidhur me hyrje-daljet e kundërshtarëve të tyre nga vendi, urdhërat e arrestit, ndalimi apo kërkimit nga agjencitë ligjzbatuese, deportimet apo masat e tjera ndaluese nga shtetet e tjera etj.

82. Referuar raportit të veprimtarisë të SPAK për vitin 2023, është vërejtur një bashkëpunim i grupeve kriminale edhe me **oficerët e policisë së shtetit të rangjeve të ndryshme në territorin shqiptar, si dhe funksionarë të organeve të drejtësisë**, të cilët kanë luajtur role të ndryshme, duke filluar që nga dekonspirimi i operacioneve policore, njoftimi për personat kundërshtarë të vënë në shënjestër nga grupet kriminale, **dhënie informacioni për individë të ndryshëm**, dhe aktivitetet të tjera në pengimin e drejtësisë. Gjithashtu në këtë raport, konstatohet se ajo që vihet re në disa raste janë edhe **lidhjet e krijuara me përfaqësues të policisë së shtetit** qoftë në nivel lokal, por dhe qendror, të cilët kanë ndihmuar grupet kriminale kryesisht në dhënien e informacioneve apo ndjekjen e lëvizjeve të kundërshtarëve të tyre. Në raportimin vjetor përpara KLP-së dhe Kuvendit të Shqipërisë, drejtuesi i SPAK, zoti Altin Dumani shprehu shqetësimin e tij lidhur me përfshirjen e punonjësve të Policisë së Shtetit, në krimin e organizuar, ku vetëm në tre vitet e fundit janë proceduar penalisht 69 punonjës policie.

83. Funksionarë të lartë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ish-zyrtarë të Drejtorive Vendore të Policisë Shkodër dhe Lezhë, janë tashmë duke u përballur me disa akuza penale në proceset gjyqësore që po zhvillohen kundër tyre. Duke pasur akses në informacione të klasifikuara dhe në të dhënat e sistemit TIMS, ata jua kanë vënë në dispozicion grupeve të ndryshme kriminale apo individëve të caktuar me rekorde penale. Në shumë raste, duke aksesuar të dhënat e sistemit TIMS, janë gjurmuar persona të caktuar kundër të cilëve janë kryer atentate për eliminimin e tyre fizik, ose ka pasur plane të kësaj natyre. Kërkimi për persona specifik në këtë sistem, për të gjurmuar lëvizjet e tyre, është informacioni më i shpeshtë që kërkohet nga grupet e ndryshme kriminale.

84. Aksesimi në databazën e të dhënave të sistemit TIMS, i shërben grupeve kriminale edhe për të regjistruar apo jo, hyrje-daljet e personave të ndryshëm sipas interesit të tyre, duke u bërë qartazi manipulimi i sistemit, për mos të regjistruar asnjë të dhënë. Në të dhënat e këtij sistemi, mund të kërkohen informacione për rekorde të ndryshme penale për persona të ndryshëm, por vlen të theksohet fakti se në këtë sistem gjenden edhe personat që janë në hetim, apo ka informacion për përfshirje në veprimtari kriminale. Pra grupet e ndryshme mund të merrnin informacion për këdo që ata kishin interes, qoftë për anëtarët e organizatës së tyre, apo për persona të tjerë. Aksesimi në këto të dhëna është përdorur edhe si mjet shantazhi për persona të ndryshëm, pasi duke pasur informacion të drejtpërdrejt për hyrje-daljet e tyre në pikat kufitare, mjete e përdorura dhe personat që kanë qenë të shoqëruar, grupet kriminale e kanë patur më të lehtë për të vënë nën presion individë të ndryshëm, në mënyrë që këta të fundit mund të kryenin veprime në interes të këtyre grupeve.

85. **Konkluzion:** Nga të dhënat publike dhe faktet e njohura botërisht, të cilat u sollën nga anëtarët e Komisionit Hetimor, rezulton se punonjës të Policisë së Shtetit, të cilët kanë për detyrë të ruajnë dhe administrojnë të dhënat e sistemit TIMS, e kanë përdorur të drejtën e aksesit për t'ua vënë në dispozicion të dhënat e këtij sistemi elementëve të krimit të organizuar, të cilët kanë interes të veçantë për t'u njohur me hyrje-daljet e shtetasve nga territori i Shqipërisë, urdhërat e arrestit, ndalimit, kërkimit, masat ndaluese nga shtetet e huaja, vendimet gjyqësore penale nga autoritetet shqiptare apo të huaja, automjetet me të cilat lëvizin shtetas të caktuar etj. Për marrjen e këtij informacioni, këta shtetas janë të gatshëm të ofrojnë shuma të konsiderueshme monetare, në mënyrë që të mësojnë në kohë reale informacione që përmban sistemi TIMS për rata vetë apo kundërshtarët e tyre. Të dhënat e sistemit TIMS iu kanë shërbyer grupeve kriminale për të bërë eliminimin e kundërshtarëve të tyre, për të kufizuar lëvizjet jashtë vendit apo edhe për t'u arratisur në rastet kur ndaj tyre janë lëshuar urdhër arreste kombëtare apo ndërkombëtare.

V. MOSREGJISTRIMI I PERSONAVE ME REKORDE KRIMINALE NË TIMS

86. Në Ligjin nr. 71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, i ndryshuar, neni 2, pika 6 parashikon: ““Verifikim kufitar” është veprimtaria që kryhet në pikën e kalimit të kufirit për të garantuar se personat, përfshirë mjetet e tyre të transportit dhe sendet që kanë në zotërim, mund të lejohen për të hyrë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ose për të dalë prej tij.”. Ndërsa, neni 14, pika 1 parashikon: “Në hyrje dhe në dalje, të gjithë personat janë subjekt i verifikimit kufitar minimal, i cili pëbërhet nga: a) verifikimi i identitetit e i shtetësisë së personit, si dhe i vlefshmërisë e i origjinalitetit të dokumentit të udhëtimit, duke përdorur pajisje teknike dhe duke u konsultuar me bazat përkatëse të të dhënave e, veçanërisht, me: i) bazat kombëtare të të dhënave që përmbajnë informacion mbi dokumentet e vjedhura, të përditësuara, të humbura dhe të zhvleftësuara të udhëtimit; ii) bazën e të dhënave të INTERPOL-it për dokumentet e vjedhura dhe të humbura të udhëtimit; iii) bazat ndërkombëtare të të dhënave të njohura nga Republika e Shqipërisë; b) verifikimi që personi, mjete i tij transportit dhe sendet që ai transporton nuk përbëjnë rrezik për rendin dhe sigurinë publike, shëndetin publik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare me shtetet e tjera, duke u konsultuar me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse. Kur ka dyshime mbi origjinalitetin e dokumentit të udhëtimit ose mbi identitetin e mbajtësit të tij, në verifikime përfshihet verifikimi i identifikuesve biometrikë të integruar në pasaportat dhe dokumentet e udhëtimit.”.

87. Nga ana tjetër, referuar shkresës nr. 3755/2 prot., datë 26.04.2024 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotit Muhamet Rrumbullaku sa i përket përmbajtjes së të dhënave të sistemit TIMS, rezulton se ky sistem përmban informacione në lidhje me: (i) gjeneralitetet e shtetasve shqiptar apo të huaj, të cilët kanë regjistruar të paktën një hyrje/dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë apo kanë një dokument udhëtimi të lëshuar nga Republika e Shqipërisë; (ii) të dhënat e dokumenteve të identifikimit, të cilët kanë regjistruar të paktën një hyrje/dalje ose janë të lëshuara nga Republika e Shqipërisë; (iii) të dhëna për automjetet, të cilët kanë regjistruar të paktën një hyrje/dalje nga territori i Republikës së Shqipërisë; (iv) informacionin e shtetasve për hyrje/daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë; (v) urdhër arrestimi, ndalimi, kërkimi, të dyshuar; (vi) shtetasve të kategorive Inad dhe Deportiv; (vii) njoftime (për shtetas, dokumente, automjete) në kufi nga çdo strukturë e Policisë së Shtetit; (viii) informacion mbi personat e ndaluar, arrestuar, shoqëruar; (ix) aplikimet për leje qëndrimi të personave me shtetësi të huaj (shkëputur nga TIMS në vitin 2024 me qëllim rritjen e performancës); (x) lejet e qëndrimit për personat me shtetësi të huaj (shkëputur nga TIMS në vitin

2024 me qëllim rritjen e performancës); (xi) kundravajtjet administrative të automjeteve dhe masat plotësuese mbi lejet e drejtimit (shkëputur nga TIMS në vitin 2024 me qëllim rritjen e performancës); (xii) personat në kërkim, dokumenta në kërkim, automjete në kërkim, kombëtar dhe ndërkombëtar etj.; (xiii) informacion për shtetas të huaj të shpallur non grata apo të cilëve ju ndalohet hyrja në Republikën e Shqipërisë.

88. Megjithëse, parashikimi ligjor është shumë i qartë sa i përket detyrimit që çdo shtetas shqiptar apo i huaj që hyn apo del nga territori i Republikës së Shqipërisë, duhet të regjistrohet në sistemin TIMS dhe për secilin duhet të kryhen kërkime të plota në të gjitha bazat e të dhënave të këtij sistemi, në fakt rezulton se në raste të caktuara hyrje-daljet nuk janë regjistruar ose sistemi nuk ka kryer kërkime të plota, si p.sh. në sistemin e INTERPOL-it nëse personi është në kërkim ndërkombëtar, ndaj tij është lëshuar urdhër arresti ndërkombëtar apo ka një vendim gjyqësor penal nga autoritetet e huaja. Ky trajtim i paligjshëm i personave të caktuar bëhet me qëllim që në rast qëndrimi më të gjatë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë të mos penalizohen, ose në rastet e individëve me rekorde kriminale, që sistemi të mos regjistrojë hyrje-daljet e tyre, ose të mossinjalizojë rastet kur janë subjekte të urdhërave të kërkimit, arrestit apo ndalimit kombëtar a ndërkombëtar.

89. Konkretisht, gjatë dëshmisë së Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, zotit Muhamet Rrumbullaku, në datën 04.06.2024, kryetari i Komisionit Hetimor, solli në vëmendje shkresën nr. 4065 prot., datë 20.12.2023 të Departamentit për Teknologjinë e Informacionit, sipas të cilës rezulton se gjatë një ekzaminimi të kryer u konstatua se për një grup prej pesë dokumentesh udhëtimi të tipit pasaportë që përkonin me shtetasit Tedi Spiro Malaveci, Aida Jaupllari, Bruno Veizaj, Nevila Xoxa dhe Lorela Shehu, sistemi nuk kryente kërkim në TIMS Kriminal, duke sjellë kështu moskontrollin e tyre ndaj listës së personave të kërkimit. Pasi u verifikuan numrat e dokumenteve, rezulton se këto dokumente janë shqiptare.

90. Lidhur me këtë pyetje, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zotit Muhamet Rrumbullaku ka pranuar vërtetësinë e dokumentit të cituar nga zoti Saliانji, por është shprehur se në këtë rast kemi të bëjmë me një luftë të brendshme brenda dy niveleve, ata që humbën funksionet me ata që morën funksionet dhe luftojnë me letrat e njëri-tjetrit. Po ashtu, gjatë dëshmisë së tij, Drejtori Rrumbullaku është shprehur se: “Mund të mos regjistrohesh dhe të biesh në kompromis me kontrollorin, por të regjistrohesh dhe të fshihen të dhënat kjo nuk ekziston. Kjo ekspertizë është e sqaruar një herë e mirë. Kjo është thjesht për siguri. Askush nga person me rekorde kriminale, me hyrje dhe dalje në sistemin TIMS, nëse regjistruar njëherë, aty i ka të pëjetshme që nga momenti i fillimit të funksionalitetit të sistemit TIMS.”.

91. Gjatë dëshmisë së tij të datës 04.06.2024, Drejtori i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit, zoti Ervin Muça ka deklaruar se: “Në datën 20.12.2023, i është dërguar memo për ndërhyrje të paautorizuar në sistemin E-gate, drejtorit të Përgjithshëm, në të cilën janë lejuar 5

numra pasaportash, për favorizime personale, duke shmangur kontrollin gjatë kufitar si person në kërkim, të cilët mund të kenë probleme me ligjin, ndërkohë që ky fakt lë shteg se kjo lloj procedure mund të jetë përdorur edhe për persona të tjerë me rekorde kriminale, që këta persona të mos kërkoheshin në regjistrin TIMS-kriminal, veprim flagrant në kundërshtim me Rregulloren e Policisë së Shtetit, i kryer dhe i pranuar nga zoti Veizaj.”.

92. Më tej, zoti Muça shprehet: “Ky fakt i evidentuar bën që nëse kërkohen në sistemin E-gate këto pesë pasaporta të dalin “Don’t care condition”. Pra nuk shkojnë të kontrollohen në TIMS-Kriminal nëse janë apo nuk janë në kërkim persona. Pra pavarësisht se mund të jetë në kërkim ai person kalon si i lirë. Ky është një manipulim i sistemit. Pyetja ime është shumë e thjeshtë, kjo ishte një indicia, sepse pot ë ishte gjetje duhej ta referoja unë në organet kompetente, e cila më lë mua të kuptoj se ky personi në momentin që ka bërë këtë gjurmën që ka menduar se nuk do të zbulohet kurrë mund të ketë bërë edhe 25 mijë gjurmë të tjera, sepse askush nuk e kontrollonte dhe monitoronte. Pra, kishim një vresht pa rojtar.”.

93. Gjatë dëshmisë së tij të datës 26.06.2024, Drejtori i Sistemeve në Departamentin e IT-së, zoti Enri Ndoni ka konfirmuar ekzistencës e memos dhe saktësinë e përmbajtjes së saj, pasi sipas tij ajo është një çështje e verifikuar, ndërsa pretendimet për persona të tjerë që mund të kenë përdorur të njëjtën mënyrë kalimi, duhet të hetohen nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit. Nga sa më sipër, është e qartë se sistemi është manipuluar që për persona të caktuar sistemi TIMS të mos kryejë regjistrimin e hyrje-daljeve nga territori i Republikës së Shqipërisë, ose në rast të kryerjes së këtij regjistrimi, kërkimi të mos bëhet i plotë në databazat kriminale, duke lejuar kështu që të hyjnë apo të dalin nga territori i vendit persona me rekorde kriminale, të cilët mund të jenë në kërkim kombëtar a ndërkombëtar për kryerjen e veprimtarive të paligjshme.

94. **Konkluzion:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se në sistemin TIMS janë kryer ndërhyrje, të cilat mundësojnë që për persona të caktuar, të mos regjistrohen hyrje-daljet e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe nëse regjistrohen, kërkimi në bazën e të dhënave të TIMS nuk bëhet i plotë duke shmangur databazat e të dhënave kriminale, çka mundëson që shtetas shqiptar apo të huaj që mund të jenë në kërkim kombëtar a ndërkombëtar, apo të dënuar për kryerjen e krimeve, të hyjnë dhe dalin lirisht nga territori pa pasur ndonjë alert nga sistemi. Ky devijim, siç është shprehur edhe Drejtori i Departamentit të IT-së, zoti Ervin Muça, iu shërben kryesisht individëve me rekorde kriminale dhe mund të shpjegojë edhe faktin se si persona në kërkim nga organet shqiptare të drejtësisë ia kanë dalë të dalin apo hyjnë në territorin e vendit tonë pa u zbuluar nga institucionet ligjzbatuese. Edhe kjo problematikë meriton vëmendje të veçantë dhe adresim të menjëhershëm pasi përbën një rrezik serioz për rendin dhe sigurinë, si dhe dëmton rëndë punën e organeve të drejtësisë, qofshin ato shqiptare apo të huaja.

VII. KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

95. **Konkluzioni i parë:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se zoti Ervin Muça nuk përmbushte kushtet për t'u emëruar në detyrën e Drejtorit të Departamentit të IT-së. Konkretisht, ky shtetas ishte proceduar penalisht për falsifikim dokumentesh në shtetin italian në vitin 2007, ishte refuzuar leja e qëndrimit në vitin 2008, nuk kishte plotësuar formularin e dekriminalizimit, nuk kishte kryer trajnimet e detyrueshme në Akademinë e Sigurisë, nuk ishte pajisur me Certifikatën e Sigurimit të Personelit dhe ishte njëkoësisht i punësuar si këshilltar i drejtoreshës së Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, megjithëse hetimet e kryera nga Prokuroria nuk kanë gjetur ndonjë produkt konkret pune.

96. **Konkluzioni i dytë:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor rezulton se procedurat e rekrutimit të ish-drejtorit Besjon Tanuzi dhe drejtorit aktual Enri Ndoni kanë qenë fiktive dhe me rezultat të paracaktuar. Kjo duket nga fakti që ata kanë aplikuar dokumentet për t'u emëruar në këto pozicione para krijimit të vakancës, nuk ka pasur asnjë shpallje për vendin vakant në këto pozicione dhe kanë qenë kandidaturat e vetme që i janë paraqitur për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nga ana tjetër, rezulton se zoti Tanuzi nuk kishte asnjë eksperiencë të mëparshme në Policinë e Shtetit apo sistemet e informatike të kësaj të fundit dhe nuk ishte pajisur me certifikatë sigurie, ndërsa duket se marrëdhënia miqësore me shtetasin Ervin Muça ka qenë vendimtare për emërimin e tij.

97. **Konkluzioni i tretë:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor rezulton se procedura e ndjekur për emërimin e Drejtores së Hetimit të Krimit Kibernetik Ervina Gjana ka qenë fiktive dhe me rezultat të paracaktuar. Kjo del qartazi nga fakti se zonja Gjana ka depozituar dokumentacionin përpara shpalljes së vendit vakant, ka qenë kandidaturë e vetme, aplikimet janë hapur vetëm për dy ditë dhe emërimi është kryer përpara trajnimit në Akademinë e Sigurisë, në shkelje të përcaktimeve ligjore të Ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit". Po ashtu, rezulton se zonja Gjana nuk kishte asnjë eksperiencë të mëparshme në hetimin e krimeve kibernetike, certifikata e saj e sigurisë nuk ishte konform detyrës së re dhe në vitin 2014 që përkon me largimin nga detyra e specialistes së Sektorit të Serverave në Drejtorin e Teknologjisë së Informacionit, ishin referuar materialet proceduriale si e dyshuar për kryerjen e veprës penale të "Vjedhjes", e parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal.

98. **Konkluzioni i katërt:** Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se njoftimi i parë për një ndërhyrje të paligjshme në sistemin

TIMS ka ardhur nëpërmjet një email-i në orën 14:51 të datës 02.08.2023 nga shefi i Sektorit të Serverave, zoti Ardit Muço, i cili iu është përcjellë drejtuesve kryesorë të Policisë së Shtetit. Më pas njoftimi i dytë ka ardhur nëpërmjet një email-i në orën 22:54 të datës 02.08.2023, ku krahas drejtuesve të Policisë së Shtetit, janë informuar mediat dhe drejtuesit kryesorë të shtetit, përfshirë Ministrin e Brendshëm dhe drejtorin e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore. Megjithë njoftimet e marra nga Ministri i Brendshëm, zoti Taulant Balla, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zoti Muhamet Rrumbullaku, Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në datën 02.08.2023, datë në të cilën ka filluar edhe ndërhyrja në sistemin TIMS, reagimi institucional ka ardhur vetëm ditën e nesërme në datën 03.08.2023. Deklarimet e zotit Balla, zotit Rrumbullaku dhe zoti Veliu sa i përket marrjes dijeni dhe komunikimeve me njëri-tjetrin janë kontradiktore dhe nuk përputhen me njëra-tjetrën. Nëse reagimi do të kishte qenë në kohë, ndërhyrja e filluar në orën 18:00 të datës 02.08.2023 dhe e shtrirë deri në orën 02:00 të datës 03.08.2023, mund të ishte parandaluar.

99. Konkluzioni i pestë: Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se shtetasi Ervin Muça, me detyrë Drejtor i Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit, së bashku me Drejtorin e Drejtorisë së Sistemeve, Besjon Tanuzaj, dhe punonjës të tjerë të Departamentit të IT-së, kanë kryer një sërë shkeljesh ligjore, duke vënë në rrezik sigurinë e sistemit të dhënave TIMS. Konkretisht, këta shtetas në bashkëpunim me njëri-tjetrin kanë lejuar hyrjen e paautorizuar në ambientet e rëndësisë së veçantë të Policisë së Shtetit, nuk kanë marrë leje apo autorizim paraprak nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për kryerjen e procesit të back-up-it, kanë bërë transferimin pjesërisht të të dhënave të sistemit TIMS në pajisje të jashtme, kanë hyrë në godinë duke përdorur kodin e një punonjëse që ishte me leje vjetore, kanë operuar në orët e vona të natës dhe jashtë orarit zyrtar, kanë urdhëruar vartësit për kryerjen e detyrave në kundërshtim me ligjin, si dhe nuk kanë hartuar aktet sipas Urdhërit Nr. 3410, datë 28.04.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Megjithë shkeljet flagrante të ligjit, këta punonjës janë pezulluar vetëm për një periudhë 5-ditore dhe më pas janë lejuar që të vijojnë punën normalisht, pa filluar procedura e shkarkimit nga detyra, në kushtet kur qoftë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ashtu edhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore kishin konstatuar kryerjen e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, dhe duke vënë në rrezik sigurinë e një infrastrukture kritike për Policinë e Shtetit.

100. Konkluzioni i gjashtë: Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor rezultoi se në datën 14 tetor 2021, ka pasur një sulm kibernetik në sistemet informatike të Policisë së Shtetit, përfshirë edhe sistemin TIMS. Ky sulm nuk është raportuar, nuk janë kryer verifikime apo hetime të thelluara, si dhe nuk janë marrë masa për pastrimin e sistemeve nga viruse të mundshme apo forcimin e masave të sigurisë për rreziqe që mund t'i kanoseshin sistemit nga sulme kibernetike. Po ashtu, rezultoi se në datën 9 shtator 2022 ka pasur një sulm të dytë të sistemeve informatike të Policisë së Shtetit, përfshirë sistemin TIMS, i cili sipas dëshmimeve ishte pasojë e drejtpërdrejtë e mosmarrjes së masave në rastin e sulmit kibernetik të tetorit 2021. Si rezultat i këtyre dy

sulmeve, drejtuesit e Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit kanë deklaruar se të dhënat e sistemit TIMS deri në shtatorin e vitit 2022 gjenden në kanale online, dhe mund të blihen nga çdo person që mund të jetë i interesuar. Lidhur me këto pretendime, të cilat mbështeten edhe në dokumentacion zyrtar nuk rezultojnë që të ketë pasur hetime të thelluara administrative apo penale nga institucionet ligjzbatuese. Moskryerja e këtyre hetimeve dhe marrja e masave të nevojshme rrit rrezikun për përsëritjen e sulmeve kibernetike me pasoja shkatërruese për sistemet kritike të Policisë së Shtetit në të ardhmen.

101. Konkluzioni i shtatë: Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se persona të caktuar kanë pasur akses të paautorizuar në sistemin TIMS. Megjithatë, ligji dhe aktet nënligjore parashikojnë në mënyrë të detajuar se si një personi i jepet akses në sistemin TIMS, mbetet e paqartë se si persona privatë, pra që nuk ushtrojnë një detyrë shtetërore që lidhet me aksesimin dhe përdorimin e sistemit TIMS, iu është akses në këtë bazë të dhënash me rëndësi të veçantë. Jo vetëm mënyra, por edhe personat që iu kanë dhënë këtë akses, qëllimet dhe motivet e këtyre personave privatë që kanë pasur akses në sistemin TIMS mbeten të paqarta dhe ngrejnë dyshime serioze për paligjshmëri. Sistemi TIMS përmban një shumëllojshmëri të dhënash, ashtu siç e kemi shpjeguar më lart, dhe aksesit i lirë nga persona të paautorizuar përbën një rrezik serioz për rendin dhe sigurinë në vendin tonë. Kjo situatë, për të cilën qoftë Ministri, ashtu edhe drejtuesit më të lartë të Policisë së Shtetit duken se ishin në dijeni, duhet të kishte nxitur këta të fundit për marrjen e masave urgjente për kryerjen e një hetimi të thelluar të hyrjeve të paautorizuar në sistemin TIMS dhe marrjen e masave që situata të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

101. Konkluzioni i tetë: Nga të dhënat publike dhe faktet e njohura botërisht, të cilat u sollën nga anëtarët e Komisionit Hetimor, rezultojnë se punonjësit të Policisë së Shtetit, të cilët kanë për detyrë të ruajnë dhe administrojnë të dhënat e sistemit TIMS, e kanë përdorur të drejtën e aksesit për t'u vënë në dispozicion të dhënat e këtij sistemi elementëve të krimit të organizuar, të cilët kanë interes të veçantë për t'u njohur me hyrje-daljet e shtetasve nga territori i Shqipërisë, urdhërat e arrestit, ndalimit, kërkimit, masat ndaluese nga shtetet e huaja, vendimet gjyqësore penale nga autoritetet shqiptare apo të huaja, automatjetet me të cilat lëvizin shtetas të caktuar etj. Për marrjen e këtij informacioni, këta shtetas janë të gatshëm të ofrojnë shuma të konsiderueshme monetare, në mënyrë që të mësojnë në kohë reale informacione që përmban sistemi TIMS për rata vetë apo kundërshtarët e tyre. Të dhënat e sistemit TIMS iu kanë shërbyer grupeve kriminale për të bërë eliminimin e kundërshtarëve të tyre, për të kufizuar lëvizjet jashtë vendit apo edhe për t'u arratisur në rastet kur ndaj tyre janë lëshuar urdhër arreste kombëtare apo ndërkombëtare.

102. Konkluzioni i nëntë: Nga dokumentacioni i administruar dhe dëshmitë e marra nga Komisioni Hetimor ka rezultuar se në sistemin TIMS janë kryer ndërhyrje, të cilat mundësojnë që për persona të caktuar, të mos regjistrohen hyrje-daljet e tyre nga territori i Republikës së Shqipërisë, si dhe nëse regjistrohen, kërkimi në bazën e të dhënave të TIMS nuk bëhet i plotë duke

shmangur databazat e të dhënave kriminale, çka mundëson që shtetas shqiptar apo të huaj që mund të jenë në kërkim kombëtar a ndërkombëtar, apo të dënuar për kryerjen e krimeve, të hyjnë dhe dalin lirisht nga territori pa pasur ndonjë alert nga sistemi. Ky devijim, siç është shprehur edhe Drejtori i Departamentit të IT-së, zoti Ervin Muça, iu shërben kryesisht individëve me rekorde kriminale dhe mund të shpjegojë edhe faktin se si persona në kërkim nga organet shqiptare të drejtësisë ia kanë dalë të dalin apo hyjnë në territorin e vendit tonë pa u zbuluar nga institucionet ligjzbatuese. Edhe kjo problematikë meriton vëmendje të veçantë dhe adresim të menjëhershëm pasi përbën një rrezik serioz për rendin dhe sigurinë, si dhe dëmton rëndë punën e organeve të drejtësisë, qofshin ato shqiptare apo të huaja.

103. Përgjegjësitë institucionale: Në vijim të konkluzioneve të mësipërme, kanë përgjegjësi për kryerjen e veprimeve a mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, duke dëmtuar rëndë interesat e shtetit dhe duke sjellë përfitime të paligjshme për shtetas të caktuar, funksionarët si vijon:

- (i) Ministri i Brendshëm, zoti Taulant Balla;
- (ii) Ish-Ministri i Brendshëm, zoti Bledar Çuçi;
- (iii) Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, zoti Muhamet Rrumbullaku;
- (iv) Ish-Drejtori i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, zoti Ardi Veliu;
- (v) Drejtori i Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit, zoti Ervin Muça;
- (vi) Ish-Drejtori i Drejtorisë së Sistemeve në Policinë e Shtetit, zoti Besjon Tanuzi;
- (vii) Ish-Drejtorja e Drejtorisë së IT-së në Policinë e Shtetit, zonja Nevila Xoxa;
- (viii) Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Policinë e Shtetit, zoti Zef Laska;
- (ix) Specialisti i Drejtorisë së IT-së në Policinë e Shtetit, zoti Bruno Veizaj.

104. Për hetimin e rolit dhe veprimtarisë së paligjshme të këtyre shtetasve, vlerësojmë se është e nevojshme të kryhet një hetim i plotë, i thelluar dhe i gjithëanshëm nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK). Kjo e fundit mund të nxjerrë në dritë edhe fakte të reja të paligjshme, ashtu si edhe të identifikojë persona të tjerë, që mund të jenë identifikuar gjatë hetimit parlamentar. Sjellim në vëmendje, se për shkak të zvarritjes së dërgimit të kërkesave për informacion nga deputetët e mazhorancës, vonesës në kthimin e përgjigjeve nga institucioneve apo moskthimin e përgjigjeve nga institucionet, si në rastin e Këshillit të Ministrave, rrëzimit të kërkesave për thirrjen e dëshmitarëve të tjerë dhe kohës së shkurtër në dispozicion, Komisioni Hetimor i Kuvendit ka qenë në pamundësi objektive për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore që do të çonin në zbardhjen e plotë të së vërtetës. Prandaj, SPAK, pasi t'i vihet në dispozicion ky material, në përputhje edhe me kompetencën e saj lëndore të parashikuar nga neni 135, pika 2, e Kushtetutës së Shqipërisë, dhe neni 75/a të Kodit të Procedurës Penale, ka mundësi të hetojë dhe zbardhë të plotë veprimtarinë e paligjshme të personave të sipërcituar.

VIII. REKOMANDIME

105. Rekomandimi i parë: Nga dokumentacioni shkresor i administruar, por edhe dëshmitë e marra, rezultoi se ka një kuadër ligjor të plotë që rregullon në tërësi bazën e të dhënave të sistemit TIMS. Në shpjegimet me shkrim apo me gojë institucionet shtetërore dhe personat e thirrur si dëshmitarë iu referuan akteve të ndryshme ligjore dhe nënligjore, si kuadri mbi të cilën operohet për administrimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave të sistemit TIMS. Në të shumtën e rasteve, dëshmitarët iu referuan akteve nënligjore në formën e procedurave standarde të punës apo manualeve të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Ndërkohë, që të gjithë dëshmitarët pranuan nevojën për ndërhyrje legjislativë me qëllim që të adresohen problematikat e evidentuara. Në këtë kuptim, rekomandimi ynë është që për sistemin TIMS duhet të miratohet një ligj i posaçëm, i cili të ketë për qëllim të rregullojë në mënyrë tërësore administrimin, ruajtjen, mbrojtjen, aksesimin dhe përdorimin e të dhënave të sistemit TIMS, në mënyrë që të shmanget çdo lloj abuzimi apo paligjshmërie që personat e ngarkuar me detyra konkrete lidhur me këtë sistem mund të shkaktojnë në të ardhmen.

106. Rekomandimi i dytë: Nisur nga problematikat që kanë rezultuar në procedurat dhe kriteret e emërimit të drejtuesve të Departamentit të IT-së dhe Hetimit të Krimit Kibernetik, rekomandojmë rishikimin e kuadrit ligjor të aplikueshëm, në mënyrë që të qartësohen dhe përforcohen kriteret ligjore për emërimin në këto pozicione. Po ashtu, të qartësohet procedura e verifikimit të kandidaturave dhe të garantohet procedura në respekt të parimeve të konkurrencës dhe meritokracisë. Këto ndërhyrje legjislativë kanë për qëllim që të eliminojnë në të ardhmen përsëritjen e situatave, ku persona me të kaluar kriminale, pa kualifikimet dhe trajnimet e nevojshme, pa dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm, të pa pajisur me certifikimet e sigurisë, me procedura fiktive dhe kandidatura unike, të mund të emërohet në pozicione të rëndësishme në Policinë e Shtetit. Kjo e fundit duhet të garantojë se çdo person që pranohet në Policinë e Shtetit, por veçanërisht ata që emërohen në nivele të larta drejtuese të përmbushin standardet më të larta të integritetit dhe profesionalizmit.


107. Rekomandimi i tretë: Nisur nga problematikat që kanë rezultuar në cënimin e sigurisë së të dhënave të sistemit TIMS që ruhen në godinën e Departamentit të IT-së të Policisë së Shtetit, hyrjes së personave të paautorizuar dhe përpjekjes për të transferuar të dhënat në pajisje të jashtme, rekomandojmë që të rishikohet kuadri ligjor, me qëllim që të përforcohen masat e sigurisë për këto ambiente, që në çdo zonë të jetë rreptësisht e përcaktuar lista e personave që mund të hyjnë dhe detyrat konkrete që ata kryejnë, dhe të merren masa që asnjë person i paautorizuar me shkrim nga titullari i institucionit të mos mundet të hyjë në këto mjedise. Çdo lloj veprimtarie e

kryer në këto godina duhet t'i nënshtrohet parimit të dokumentimit, në formë shkresore ose elektronike, dhe t'i nënshtrohet kontrolleve të vazhdueshme nga një strukturë e pavarur auditi. Në këtë kuptim, rekomandojmë që Policia e Shtetit të marrë masa për të kryer një auditim ndërkombëtar të Departamentit të IT-së në Policinë e Shtetit, dhe raporti përkatës t'i vihet në dispozicion Komisionit Parlamentar të Sigurisë Kombëtare.

108. Rekomandimi i katërt: Me qëllim adresimin e këtyre rekomandimeve, veçanërisht ato që lidhen me plotësimin, ndryshimin apo rishikimin e kuadrit ligjor, rekomandojmë që në Kuvendin e Shqipërisë të ngrihet një grup i përbashkët pune, me përfaqësues nga ky Komision dhe Komisioni i Sigurisë Kombëtare, si dhe përfaqësues nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore dhe partnerët ndërkombëtarë, i cili të konkludojë me ndryshimet ligjore që janë të nevojshme dhe të miratohen me konsensus të të gjitha palëve. Kjo pasi, për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion, volumit të madh të punës, zvarritjeve të qëllimshme, por veçanërisht për shkak se nisma të tilla ligjore kërkojnë kohë dhe një ekspertizë të lartë teknike, Komisioni Hetimor e ka pasur të pamundur për të konkluduar vetë me një projektligj. Por, ky qëllim mund të realizohet nëpërmjet grupi të përbashkët dhe gjithëpërfshirës pune, nisur edhe nga deklarimi i bërë nga Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe Shërbimi Informativ Shtetëror se janë duke punuar për të propozuar disa ndryshime ligjore relevante.

KRYETARI

Ervin SALIANJI



SHTOJCA 1
LISTA E ANETAREVE
TE KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR
PËR SISTEMIN TIMS
MIRATUAR ME VENDIMIN NR 20 DATE 21-03-2024
TE KUVENDIT TE SHQIPËRISË

<i>ERVIN SALIANJI</i>	<i>KRYETAR</i>
<i>TONI GOGU</i>	<i>NENKRYETAR</i>
<i>XHEMAL QEFALIA</i>	<i>SEKRETAR</i>
<i>NASIP NACO</i>	<i>ANETAR</i>
<i>ANTONETA DHIMA</i>	<i>ANETAR</i>
<i>ETILDA GJONAJ</i>	<i>ANETAR</i>
<i>LINDITA METALIAJ</i>	<i>ANETAR</i>
<i>LEFTER GESHTENJA</i>	<i>ANETAR</i>
<i>LUAN BACI</i>	<i>ANETAR</i>
<i>ELDA HOTI</i>	<i>ANETAR</i>
<i>RAMADAN LIKA</i>	<i>ANETAR</i>
<i>ASLLAN DOGJANI</i>	<i>ANETAR</i>
<i>BLERINA GJYLAMETI</i>	<i>ANETAR</i>
<i>BARDHYL KOLLCAKU</i>	<i>ANETAR</i>
<i>DENIS DELIA</i>	<i>ANETAR</i>

Anëtarët Zëvendësues

<i>Z. Eduard Ndreca (PS)</i>	<i>ANETAR</i>
<i>Z. Laert Duraj (PS)</i>	<i>ANETAR</i>
<i>Z. Klevis Xhoxhi (PS)</i>	<i>ANETAR</i>
<i>Z. Bujar Çela (PS)</i>	<i>ANETAR</i>
<i>Znj. Pranvera Resulaj (PS)</i>	<i>ANETAR</i>
<i>Bledion Nallbati (PD)</i>	<i>ANETAR</i>
<i>Isuf Çelaj (PD)</i>	<i>ANETAR</i>

SHTOJCA 2
LISTA E DESHMITAREVE
TE THIRRUR
NGA
KOMISIONI HETIMOR PARLAMENTAR
PER SISTEMIN TIMS

Emër, Mbiemër	Funksioni
Taulant Balla	Ministër i Brendshëm
Muhamet Rrumbullaku	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit
Florian Sulejmani	Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore
Ardi Veliu	Ish-Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore
Saimir Boshnjaku	Drejtori i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit
Zef Laska	Drejtor i Burimeve Njerëzore Policia e Shtetit
Nëritan Nallbati	Drejtor i Departamentit të Policisë Kriminale
Dorjan Tola	Drejtor i AKSIK
Ervin Muca	Drejtor i Departamentit të IT, Policia e Shtetit
Ervina Gjana	Drejtor i Kriminologjisë
Besjon Tanuzi	Ish Drejtor i Sistemeve, Policia e Shtetit
Enri Ndoni	Drejtor i Sistemeve, Policia e Shtetit
Ardit Muca	Shef i sektorit IT, Policia e Shtetit
Besnik Dervishi	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Përsonele
Vlora Hysëni	
Genti GAZHELI	Kryetare, Shërbimi Informativ Shtetëror

Edmond RRUSHI	Drejtori i Përgjithshëm i Doganave
Lunëda SUFALI	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Ardian BALI	Inspektorati Shtetëror Shëndetësor
Ervin KOCI	Agjencia e Intëligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
	Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave

SHTOJCA 3
KRONOLGJIA E VEPRIMEVE
NE KOHE
PER VEPRIMTARINE E
KOMISIONIT HETIMOR PARLAMENTAR
PER SISTEMIN TMS

Veprimet	Afati maksimal
Mbledhja e dokumentacionit	Brenda datës 24 Prill 2024
Shqyrtimi paraprak i dokumentacionit dhe vlerësimi i nevojës për dokumentacion shtesë – Miratimi i Planit të Hetimit	Brenda datës 30 Prill 2024
Pyetja e dëshmitarëve	Brenda datës 5 Qershor 2024
	4
Analizimi i akteve dhe dokumenteve	Brenda datë 20 Qershor 2024
Shqyrtimi përfundimtar dhe nxjerrja e konkluzioneve të hetimit – Mbyllja e Hetimit	Brenda datës 5 Korrik 2024
Prezantimi i Raportit Final të Komisionit	Brenda datës 21 Korrik 2024.

SHTOJCA 4
LISTA E PROVAVE
TE ADMINISTRUARA
PER KOMSIONIN HETIMOR PARLAMENTAR TIMS

- Shkresa nr.1073/1prot, date 22-04-2024* *percjelle nga Komisioneri Per te Drejten e Informimit*
- Shkresa nr.2249prot, date 24-04-2024* *percjelle nga AKSIK*
- Shkresa nr.4546/1prot, date 96-04-2024* *percjelle nga Ministria e Brendshme*
- Shkresa nr.1561prot, date 26-04-2024* *percjelle nga Agjencia e Mbikeqyrjes Policore*
- Shkresa nr.3755/2prot, date 26-04-2024* *percjelle nga Drejtoria e Pergjithsme e Policise se Shtetit*
- Shkresa nr.6123/1prot, date 25-04-2024* *percjelle nga Prokuroria e Posacme Kunder Korrupsionit dhe Krimet te Organizuar*
- Shkresa nr.110972prot, date 09-05-2024* *percjelle nga Prokuroria prane gjykates se shkalles se pare te juridiksionit te pergjithshem Tirane*

SHTOJCA 5
PËRMBLEDHËSE E TE DHËNAVE
DOKUMENTARE TE PËRDORURA
PËR TE NDËRTUAR KËTË RAPORT
AKTET NORMATIVE

QË RREGULLOJNE SHËRBIMIN PËR SISTEMIN TIMS

- i. Ligj nr. 71/2016 “Për kontrollin kufitar” (i ndryshuar) me ligjin nr. 22/2020, datën 5.3.2020)
- ii. Ligj nr. 108/2014 “Per policinë e shtetit”,
- iii. *Udhëzim nr.579 date 20-10-2026, Fletore Zyrtare nr.202/2016, ”Per informacionin qe ju jepet personave te cilët janë subjekt i verifikimeve ne vijën e dYTE ne pikat e kalimit kufitar”.*
- iv. *Rregullore VKM nr.750 datë 16.09.2015*
- v. Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.143, datë 04-02-2022
- vi. Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1057, datë 15.11.2021
- vii. *Urdheri Nr.1057/e, datë 15.11.2021 ”Procedura standarte për sigurinë Informatike në Policinë e Shtetit”*
- viii. *Programi i Punës i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me Nr.3410, datë 28.4.2023 ”Për rishikimin e Procedurave standarte të Punës për të gjithë strukturat e Policisë së Shtetit”*
- ix. *Manual ”Për Sigurinë e Informacionit” miratuar meUrdhërin Nr.1237, datë 31.8.2023*
- x. *Manual ”Për vazhdueshmërinë e punës, në rastet e ndodhjes së një incidenti, ndërprerje të shërbimeve apo fatkeqësive” miratuar me Urdhërin Nr.1238, datë 31.8.2023*

SHTOJCA 6
LISTA E EKSPERTEVE LIGJORE
TE MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 2 DATE 08-04-2024
TE KOMISIONIT HETIMOR PER SISTEMIN TIMS

<i>VJOSA BODO MUJO</i>	<i>EKSPERT LIGJOR</i>
<i>DRITAN JAHAJ</i>	<i>EKSPERT LIGJOR</i>
<i>HENRI BICI</i>	<i>EKSPERT LIGJOR</i>
<i>KRESHNIK MYFTARI</i>	<i>EKSPERT LIGJOR</i>